



safejournalists.net

MAQEDONIA E VERIUT **Treguesit për shkallën e lirisë** **së mediave dhe Indeksi i** **Sigurisë së Gazetarëve** **2025**

Autorët
Milan Spirovski
Verçe Todorovska Kostovska



PËRMBAJTJA

Për projektin

Zhvillim i treguesve

Shënim metodologjik

Indikatorë kualitativë për shkallën e

lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve

Indeksi i sigurisë së gazetarëve

Listë e shkurtesave

I Hyrje

II Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – Treguesit

A. Garancitë ligjore dhe zbatimi i tyre

A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë 9

A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i organit rregullator 10

A.3 Pavarësia dhe autonomia e servisit publik mediatik 11

A.4 Mbështetje financiare për gazetari cilësore dhe përmbajtje mediatike me interes publik 12

A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin privat të medias 13

A.6 Dispozitat ligjore që lidhen me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekt frikësues për gazetarët dhe median 15

A.7 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatikë të punojnë lirshëm dhe në mënyrë të sigurt 15

A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet 16

A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen dhe të marrin pjesë në shoqatat e tyre 16

A.10 E drejta për qasje në dokumente dhe informacione zyrtare 17

B. Pozita e gazetarëve në redaksi 20

B.1 Pozita e punës e gazetarëve është e qëndrueshme dhe e mbrojtur në vendin e punës 20

B.2 Pavarësia redaktuese në mediat private 21

B.3 Pavarësia redaktuese në servisin publik mediatik 21

B.4 Pavarësia redaktuese në sektorin mediatik jofitimprurës 22

B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve 24

B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve 24

2 C. Siguria e gazetarëve 26

2 C.1 Gazetarët dhe aktorët mediatikë kanë qasje në masa të menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve 26

4 C.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatikë (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri 26

7 C.3 Gazetarët kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore 27

C.4 Është vendosur praktika e dënimit publik të rregullt të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave 28

C.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve 29

C.6 Njësitë e specializuara hetimore dhe/ose zyrtarët kanë ekspertizën e duhur për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve 30

C.7 Hetimet për sulme serioze fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatikë kryhen në mënyrë efikase (të pavarur, të thelluara dhe në kohë) 30

C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatikë mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet 31

C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatikë kryhen në mënyrë transparente 32

C.10 Sistemet për mbledhjen e të dhënave statistikore cilësore janë vendosur nga organet shtetërore për të parandaluar mosndëshkimin 32

C.11 Kërcënime dhe ngacmime që nuk lidhen me sigurinë fizike 33

C.12 Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve 34

C.13 Sulme reale 34

C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve 35

III Përfundime dhe rekomandime 36

IV Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – 2025 39

Për projektin

ZHVILLIM I TREGUESVE

Shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbështetura nga Komisioni Evropian¹, themeluan platformën [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) për të ndjekur së bashku legjislacionin dhe praktikën e mediave në vendet e tyre dhe për t'u angazhuar në përmirësimin e mjedisit ligjor dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias. Çdo vit, bazuar në një metodologji të dizajnuar me kujdes², partnerët e [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) realizojnë një hulumtim për përfaqësim, i cili u siguron shoqatave të gazetarëve të dhëna të besueshme dhe relevante, të bazuara në dëshmi, për problemet kryesore dhe pengesat në zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë dhe sigurisë së mediave dhe gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet e hulumtimit u japin përmbajtje aktiviteteve të partnerëve, duke u ofruar dëshmi dhe shembuj të rinj që i rafinojnë dhe i forcojnë pozicionet e tyre për përfaqësim.

Mjeti i parë kërkimor cilësor – *Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve*, për herë të parë u zhvillua në vitin 2016 dhe u përshtat gradualisht me kalimin e viteve. Ajo përbëhet nga tri grupe treguesish: (A) Mbrojtja ligjore, (B) Pozita e gazetarëve në redaksi dhe (C) Siguria e gazetarëve. Bazuar në këtë mjet monitorimi, janë publikuar gjithsej shtatë vlerësime, më e fundit për vitin 2022.

Mjeti kërkimor sasior – *Indeksi i sigurisë së gazetarëve*, u zhvillua në vitin 2020 dhe u testua në vitin 2021. Është projektuar për të "matur" ndryshimet në mjedis që kanë ndikim të drejtpërdrejtë

- 1 Në dhjetor të vitit 2022, Komisioni Evropian miratoi një cikël të ri trevjeçar projektesh për platformën [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), i cili është vazhdim i dy fazave të mëparshme: projekti Platforma Rajonale për Përfaqësim për Liritë Mediatike dhe Sigurinë e Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (janar 2016 – dhjetor 2018) dhe [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) (shkurt 2020 – mars 2023). Qëllimi kryesor i projektit është të forcojë rolin e shoqatave kombëtare të gazetarëve, anëtare të Platformës Safejournalists.net, për t'u bërë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm në përfaqësim dhe në krijimin e politikave relevante mediatike në vendet e tyre: Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë, Shoqata e Gazetarëve të Bosnjë e Hercegovinës, Shoqata e Gazetarëve të Kroacisë, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë dhe Sindikata e Mediave të Malit të Zi. Projekti financohet nga Programi i BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile dhe mediave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi për periudhën 2021–2023 (IPA III).
- 2 Hulumtimi për përfaqësim është dizajnuar dhe koordinohet nga Snezhana Tërpevska dhe Igor Micevski, hulumtues në Institutin për Hulumtimin e Zhvillimit Shoqëror RESIS nga Maqedonia e Veriut – www.resis.mk.

ose të tërthortë në ndjenjën e sigurisë së gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatikë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Ai përbëhet nga katër grupe treguesish: (1) Mjedisi ligjor dhe organizativ, (2) Parandalimi, (3) Procesi dhe (4) Siguria faktike. Bazuar në këtë mjet, janë realizuar gjithsej tre cikle kërkimore: 2020 (viti pilot), 2021 dhe 2022.

Duke filluar nga viti 2023, [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) do t'i kombinojë të dyja mjetet kërkimore (cilësore dhe sasiorë) në një projekt të vetëm kërkimor për përfaqësim – *Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe Indeksi i sigurisë së gazetarëve*. Platforma monitoron gjendjen në shtatë vende: Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosovë³ dhe Serbi.

SHËNIM METODOLOGJIK

I gjithë procesi kërkimor është i ndarë në dy faza: në fazën e parë mblidhen të dhëna për të gjithë treguesit cilësorë – si për liritë mediatike ashtu edhe për sigurinë e gazetarëve, ndërsa në fazën e dytë, treguesit cilësorë për sigurinë e gazetarëve shndërrohen në tregues sasiorë dhe zbatohet procedura e vlerësimit dhe llogaritjes së Indeksit të sigurisë së gazetarëve.

Janë përdorur një sërë metodash të ndryshme kërkimore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave që lidhen me secilin tregues cilësor:

- Shqyrtim i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizë cilësore e dokumenteve ligjore;
- Kërkim dhe analizë e informacioneve të publikuara në faqet e internetit të institucioneve publike dhe organizatave e trupave të tjera;
- Kërkim dhe analizë e komunikatave për media, publikimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhëna dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, hartues politikash etj.;
- Grupe fokusi me gazetarë, dhe
- Anketa me gazetarë (në disa nga vendet).

Në nivel kombëtar, hulumtimi për përfaqësim realizohet nga hulumtues kombëtarë, të cilët mbledhin të dhënat dhe përgatisin raportet narrative, të cilat më pas rishikohen

³ Ky emërtim është pa paragjykim ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën dhe pavarësinë e Kosovës.

nga ekspertë lokalë të medias dhe të drejtës dhe nga hulumtuesi kryesor. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) e ka nominuar Milan Spirovskin si hulumtues kombëtar.

INDIKATORË KUALITATIVË PËR SHKALLËN E LIRISË SË MEDIAVE DHE SIGURINË E GAZETARËVE

Në tabelën vijuese paraqiten të gjitha treguesit kualitativë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve, të ndarë në tri fusha. Këta tregues kualitativë paraqiten në formë përshkruese ose narrative. Indikatorët që përdoren në kuadrin konceptual për Indeksin e sigorisë së gazetarëve në tabelë janë të shënuar me ngjyrë gri.

Pasqyrë e të gjithë treguesve cilësorë (Treguesit për nivelin e lirisë së medias dhe sigorisë së gazetarëve)

A. Garancitë ligjore dhe zbatimi i tyre në praktikë	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe zbatimi i tyre në praktikë	B.1 Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	C.1 Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve
A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i organit rregullator	B.2 Pavarësia redaktoriale në mediat private	C.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri
A.3 Pavarësia dhe autonomia e servisit publik mediatik	B.3 Pavarësia redaktoriale në radiodifuzerin publik	C.3 Gazetarët kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore
A.4 Mbështetje financiare për gazetari cilësorë dhe përmbajtje mediatike me interes publik	B.4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës	C.4 Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave
A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e medias private	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	C.5 Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve
A.6 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediave	B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve (femra)	C.6 Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve
A.7 Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt		C.7 Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)
A.8 Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet		C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet
A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrijnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre		C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente
A.10 E drejta e qasjes në dokumente dhe informacione zyrtare		C.10 Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit
		C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike
		C.12 Kërcënimet ndaj jetës dhe sigorisë fizike të gazetarëve
		C.13 Sulmet reale

INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE

Duke marrë parasysh standardet dhe rekomandimet e vendosura nga Këshilli i Evropës dhe nga organizata të tjera ndërkombëtare, koncepti i "sigurisë së gazetarëve"⁴ u operacionalizua duke marrë parasysh katër dimensionet në vijim:

- I. **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave ligjore mbrojtëse relevante për sigurinë e gazetarëve.
- II. **Parandalimi** – ekzistenca dhe zbatimi i një serie masash parandaluese që kanë efekt të drejtpërdrejtë mbi mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve.
- III. **Procesi** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor penal dhe civil në hetimin e kërcënimeve dhe aktëve të dhunës ndaj gazetarëve.
- IV. **Siguria reale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe aktëve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Në tabelën më poshtë paraqiten katër dimensionet dhe treguesit që përbëjnë modelin teorik të konceptit "siguria e gazetarëve". Të dhënat për të gjithë këta tregues u mblodhën në fazën e parë të hulumtimit, ndërsa në fazën e dytë, bazuar në dëshmitë e mbledhura nga hulumtimi, nëntë anëtarë të Panelit Këshillues⁵ nga secili vend e vlerësuan gjendjen dhe ndanë pikë për secilin nga 19 treguesit:

Përmbledhje e indikatorëve të lidhur me Indeksën e Sigurisë së Gazetarëve

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi	III. Procesi	IV. Siguriareale
1.1 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe medime	2.1 Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve	3.1 Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	4.1 Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike
1.2 Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	2.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri	3.2 Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)	4.2 Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

4 Hulumtuesit e Institutit RESIS (www.resis.mk), Snezhana Tërpevska, Igor Micevski dhe Lubinka Popovska-Tosheva zhvilluan kuadrin konceptual dhe metodologjik për Indeksën dhe modelin për vlerësimin, ponderimin dhe llogaritjen e tij.

5 Anëtarët e Panelit Këshillues në Maqedoninë e Veriut ishin: Zoran Riçliev, Milka Smilevska, Vesna Nikodinovska, Aleksandra Bogdanovska, Jovica Paunoski, Aleksandra Denkovska, Era Gjakova, Stefaniya Maneva dhe Kristian Landov.

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi	III. Procesi	IV. Siguriareale
1.3 Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	2.3 Gazetarët kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore	3.3 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet	4.3 Sulmet e realta
1.4 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre	2.4 Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	3.4 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente	4.4 Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë
1.5 Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	2.5 Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve	3.5 Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit	

Shënim: Në këtë raport, forma gjuhësore mashkullore përdoret si formë gjinore neutrale dhe u referohet individëve të gjinisë femërore, mashkullore ose të një gjinie tjetër. Përdorimi i formave të shumta gjinore shmanget për hir të lexueshmërisë më të mirë të raportit.

LISTË E SHKURTESAVE

ASHMAAV – Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale

KSHZ – Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

RTM – Radio Televizioni Maqedonas

SHGM – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

LPCFSH – Ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje

IRL – Laboratori i Gazetarëve Hulumtues

MSHIA – Ministria për Shoqërinë Informatike dhe Administratën

MTD – Ministria e Transformimit Dixhital

IMM – Instituti Maqedonas i Mediave

AIM – Agjencia Informatike Mediatike

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

SPGPM – Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias

KEMM – Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedonisë

Hyrje

Të dhëna bazë për vendin: Republika e Maqedonisë së Veriut është një demokraci parlamentare, në të cilën, pas çdo cikli zgjedhor, pushteti formohet përmes një simbioze politike ndërmjet partive më të suksesshme nga blloku maqedonas dhe ai shqiptar. Përbërja multietnike e shtetit shton kompleksitet në peizazhin shoqëroro-politik, gjë që reflektohet edhe në sferën mediatike. Sipas regjistrimit⁶ së popullsisë dhe amvisërive nga viti 2021, vendi numëron 1.836.713 banorë. Harta etnike tregon se 58,44% janë maqedonas, 24,30% shqiptarë, 3,86% turq, 2,53% romë, 0,47% vlllehë, 1,30% serbë, 0,87% boshnjakë, ndërsa pjesa tjetër i përket komuniteteve më të vogla. Larmia fetare reflektohet në faktin se 46,14% janë ortodoksë, 32,17% myslimanë, 0,37% katolikë, ndërsa një përqindje e vogël janë deklaruar si agnostikë ose pjesëtarë të grupeve dhe komuniteteve të tjera fetare.

Konteksti politik: Në vitin 2024, zgjedhjet parlamentare çuan në ristrukturime të ndryshme të brendshme të partive politike. Në vend, pas këtyre zgjedhjeve, pushtetin e mori VMRO-DPMNE, në koalicion me koalicionin politik shqiptar VLEN. Skena politike ishte e paqëndrueshme për shkak të thellimit të ndarjeve ndërmjet pushtetit dhe opozitës, e shoqëruar me sfida për partitë politike në Maqedoninë e Veriut, ndërsa çështje të rëndësishme si integrimi evropian dhe marrëdhëniet me fqinjët e forcuan këtë paqëndrueshmëri. Këto tensione u reflektuan edhe në peizazhin mediatik, ku u shtuan akuzat për presione politike mbi politikën redaktuese dhe raportim selektiv. Si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Maqedonia e Veriut mbetet nën monitorim të vazhdueshëm për sundimin e ligjit, lirinë e mediave dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Gjendja ekonomike: Pamja ekonomike në vitin 2025 ishte e ndërthurur me sfida globale dhe turbulencë të brendshme ekonomike. Inflacioni

6 Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021](#).

dhe kriza energjetike e tronditën ndjeshëm stabilitetin e përgjithshëm ekonomik, ndërsa pasojat u ndjenë edhe në sektorin e mediave. Shumë media u përballën me sfida financiare, duke rezultuar në përkeqësim të mëtejshëm të statusit socio-ekonomik të gazetarëve dhe në shkurtrim të buxheteve për gazetari hulumtuese dhe raportim cilësor. Tregu i reklamave mbeti i ngushtë, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e mjeteve reklamuese u zhvendos drejt platformave digjitale, duke ulur më tej të ardhurat e mediave tradicionale. Kjo paqëndrueshmëri ekonomike krijoi hapësirë për rritjen e varësisë së mediave nga interesat politike dhe korporative, duke vënë në provë pavarësinë e tyre redaktuese.

Mjedisi rregullator: Në vitin 2025, sektori mediatik në Maqedoninë e Veriut mbeti nën presion të fortë ekonomik dhe institucional, me rrezik për rritje të varësisë nga subvencionet politike, gjë që vazhdon ta cenojë pavarësinë redaktuese. Korniza rregullatore, e udhëhequr nga ASHMAAV, vazhdoi të përballëte me mungesë të pavarësisë funksionale, ndërsa si ASHMAAV ashtu edhe servisi publik RTM morën drejtim të ri pas një periudhe të gjatë në të cilën mandatet e anëtarëve të organeve të tyre drejtuese kishin skaduar. Me këtë, pas një bllokade institucionale disa vjeçare, u bënë ndryshime kadrovike në dy institucione kyçe të sektorit mediatik. Megjithëse u bënë disa ndërhyrje ligjore – si heqja e moratoriumit për reklamimin shtetëror për rikthimin e praktikës së fushatave shtetërore në mediat private, si dhe përditësimi teknik i Ligjit për Media në pjesën e gjobave – reformat thelbësore në ligjet për media munguan. Komisioni Evropian në raportin e tij⁷ përsëri paralajmëroi për progresin e ngadalshëm në pluralizmin mediatik, duke theksuar nevojën për reforma urgjente për të siguruar një skenë mediatike të lirë dhe të pavarur. Në raport, Komisioni Evropian thekson se Maqedonia e Veriut ka arritur një nivel të caktuar deri në nivel të moderuar përgatitjeje në fushën e lirisë së shprehjes dhe ka shënuar progres të kufizuar në këtë drejtim. Korniza ligjore që rregullon mediat ende nuk është plotësisht e harmonizuar me të drejtën e BE-së, veçanërisht me Aktin Evropian për Lirinë e Mediave (EMFA)⁸, megjithëse është arritur një progres i caktuar në Ligjin për Media.

7 Komisioni Evropian, [Dokument pune i shërbimeve të Komisionit: Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2025](#), nëntor 2025.
8 Akti Evropian për Lirinë e Mediave – [EMFA](#).



Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – Treguesit

A. GARANCITË LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

– A.1 GARANCITË THEMELORE PËR LIRINË E MEDIAVE DHE GAZETARËVE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Garancitë themelore për lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e mediave, përveç në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, janë të përfshira në ligjet për media dhe në disa ligje të tjera⁹. Të gjitha këto ligje përfshijnë edhe të drejtën për qasje në internet, pra nuk ekziston një rregullore e veçantë që rregullon vetëm internetin.

E drejta për lirinë e shprehjes, përfshirë edhe hapësirën në internet, ushtrohet lirshëm nga qytetarët, gazetarët, organizatat mediatike dhe të tjera. Në vitin 2025 nuk është regjistruar asnjë rast i dokumentuar në të cilin qeveria ose ndonjë organ shtetëror të ketë tentuar të bllokojë ose filtrojë përmbajtje në internet. Në raportin më të fundit të Reporterëve pa Kufij (RSF)¹⁰, krahasuar me vitin 2024, Maqedonia e Veriut shënon rënie prej gjashtë pozicionesh në Indeksin Botëror të Lirisë së Mediave për vitin 2025 dhe renditet në vendin e 42-të. Në aspektin ligjor, raporti thekson se legjislacioni kombëtar ende nuk është i harmonizuar me standardet evropiane, ndërsa keqpërdorimi i padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) përbën një mjet presioni ndaj mediave dhe gazetarëve kritikë. Në pjesën për sigurinë, raporti evidenton raste të frikësimit, presioneve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, veçanërisht ndaj atyre që raportojnë për keqpërdorimin e pushtetit dhe korrupsionin. Raporti gjithashtu thekson se bartësit e funksioneve publike shfaqin qëndrime negative dhe poshtëruese ndaj gazetarëve.

9 Këto garanci janë të përfshira në Ligjin për Media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjin për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik, Ligjin për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje, si dhe në ligje të tjera.

10 Indeksi vjetor i Reporterëve pa Kufij – [Republika e Maqedonisë së Veriut 2025](#).

Reformat në sektorin mediatik, ndonëse prej kohësh të identifikuar si të nevojshme, u iniciuan në vitin 2023. Projekti *“Harmonizimi i legjislacionit kombëtar mediatik me të drejtën e BE-së dhe standardet mediatike”*, i mbështetur nga BE-ja, në fazën e parë u fokusua në harmonizimin me Direktivën për Shërbimet Audiovizive të vitit 2018, ndërsa në fazën e dytë në një reformë gjithëpërfshirëse të ligjeve mediatike. U përgatitën disa analiza dhe propozime, por procesi u ndërpre për shkak të presionit nga televizionet më të mëdha private dhe vendimit të pushtetit të atëhershëm për t’i dhënë përparësi rikthimit të reklamimit “shtetëror” (ose qeveritar) në mediat radiodifuzive. Në prill të vitit 2025, Kuvendi miratoi ndryshime në Ligjin për Media, me të cilat botuesit e mediave online – publikimet në internet – njihen si subjekte juridike në sferën mediatike.¹¹

Për themelimin e një mediumi të shtypur ose online në vend nuk ekzistojnë licenca apo kërkesa të tjera të rrepta. Mediat e shtypura dhe ato online i nënshtrohen një rregullimi minimal përmes dispozitave të Ligjit për Media, në aspektin e detyrimeve bazë për transparencë në punë, mbrojtjen e burimeve të informacionit, mbrojtjen e të drejtave të publikut të mitur, ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe thirrjes për dhunë, si dhe disa detyrime të tjera.

— A.2 PAVARËSIA DHE EFIKASITETI I ORGANIT RREGULLATOR

Mandati i anëtarëve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAAV) skadoi që në vitin 2018, pas së cilës u shpallën dy konkurse publike të pasuksesshme për zgjedhjen e anëtarëve të rinj. Konkursi i tretë, i shpallur në vitin 2024¹², u zhvillua me transparencë të kufizuar dhe pa pjesëmarrjen e sektorit civil, ndërsa përbërja e re e Këshillit të ASHMAAV-së u votua nga Kuvendi i RMV-së në qershor të vitit 2025.¹³

Në vitin 2025, nuk janë vërejtur raste të veprimit politikisht të njëanshëm, të padrejtë apo diskriminues nga ana e ASHMAAV-së ndaj mediave që i mbikëqyr, megjithëse pati ankesa nga partia politike LEVICA se ishte diskriminuar gjatë fushatës politike për zgjedhjet lokale të vitit 2025¹⁴. Sipas informacioneve të disponueshme në faqen zyrtare të ASHMAAV-së, në vitin 2025, bazuar në monitorimet e realizuara, ASHMAAV ka shqiptuar disa paralajmërime publike ndaj radiodifuzerëve për shkelje të ndryshme të detyrimeve ligjore. Në procesin e dhënies së licencave dhe zbatimit të akteve nënligjore përkatëse në fushën audiovizuale, rregullatori ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe neutrale. Megjithatë, me ndryshimet në nenin 79 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të miratuara në shkurt të vitit 2024,¹⁵ cenohet pavarësia e organit rregullator, pasi i hiqet kompetenca për të vendosur mbi

11 [Ligji për Media](#), tekst i konsoliduar, Ministria e Transformimit Digjital.

12 [“Lojë e dakorduar partiake për përbërjen e re të Agjencisë së Mediave”](#), PRIZMA, 30.01.2025.

13 Sloboden Peçat [“Në komisionin kuvendor u prezantuan kandidatët e rinj për anëtarë të Këshillit të ASHMAAV-së”](#), nëntor, viti 2025.

14 [Nuk ka reklama të financuara nga shteti për një parti me gjashtë deputetë, ndërsa ka për ato pa asnjë](#), 360 gradë, 25.09.2025.

15 [Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale](#), (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 55/2024).

rinovimin e licencave në bazë të kontributit të radiodifuzerit në larmishmërinë e programit dhe pluralizmin mediatic në tërësi.¹⁶

— A.3 PAVARËSIA DHE AUTONOMIA E SERVISIT PUBLIK MEDIATIK

Autonomia dhe pavarësia e servisit publik mediatic, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM), janë pjesërisht të garantuara me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV). Ligji përmban një dispozitë të përgjithshme që garanton pavarësinë e RTM-së nga shteti dhe nga personat juridikë dhe organet e tjera, por kjo garanci është e pamjaftueshme. Nuk ekziston një dispozitë eksplicite që të garantojë se redaksitë informative të RTM-së janë të pavarura dhe autonome në krijimin e programit, megjithëse neni 61 garanton të drejtën e redaktorëve dhe gazetarëve për pavarësi. Në nenin 104 të LSHMAAV-së përcaktohet se gazetarët, redaktorët dhe personat e tjerë të përfshirë në prodhimin programor nuk konsiderohen si punonjës administrativë/publikë, por kanë një status të veçantë dhe marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me rregulla të posaçme, jo si për të punësuarit në sektorin publik. Megjithatë, drejtuesit e RTM-së kërkojnë miratim nga tre ministri për këto çështje, gjë që krijon presion mbi punën e gazetarëve dhe redaktorëve dhe vë në pikëpyetje pavarësinë e tyre redaktuese. Për të arritur autonomi të plotë institucionale të RTM-së, janë të nevojshme ndryshime shtesë¹⁷ dhe në ligje të tjera.¹⁸

Kyçe për autonominë e servisit publik është financimi i tij i qëndrueshëm dhe i pavarur. Me ndryshimet në nenin 105 të LSHMAAV-së, të miratuara në korrik të vitit 2023, mjetet për funksionimin dhe zhvillimin e RTM-së sigurohen nga Buxheti, në masën prej 1% të të ardhurave tatimore të realizuara, të përcaktuara në llogarinë përfundimtare të fundit të Buxhetit¹⁹. Këto mjete nuk janë të dedikuara vetëm për RTM-në; një pjesë e tyre shkon për NP Radiodifuzioni Maqedonas dhe për ASHMAAV-në. Megjithëse këto ndryshime ligjore parashikojnë një financim më të qëndrueshëm, gjatë dy viteve të fundit janë shfaqur mangësi në model. Në vitin 2025, mjetet e dedikuara për mbështetjen financiare të funksionimit të rregullt që RTM-ja i merr nga Buxheti i RMV-së ishin planifikuar në vlerë prej 1.261.864.000 denarësh. Megjithatë, me ribalancin e Buxhetit të RMV-së për vitin 2025, ato u ulën për 80.000.000 denarë dhe tani planifikohen në vlerë prej 1.181.864.000 denarësh. RTM-ja nuk ka një projektim financiar shumëvjeçar në planin e saj strategjik.²⁰, që do të thotë se investimet kapitale nuk

16 Jo vetëm që ky kriter është fshirë nga neni 79, por është futur edhe një dispozitë absurde, me të cilën nënkuptohet se radiodifuzerët mund të transmetojnë gjuhë të urrejtjes, të bëjnë thirrje për përmbysjen e rendit kushtetues, të rrezikojnë sigurinë kombëtare, të transmetojnë përmbajtje të dëmshme për zhvillimin e të miturve dhe përmbajtje të tjera të dëmshme. Konkretisht, sipas nenit të ri 79, rregullatori nuk mund të refuzojë vazhdimin e lejes, përveç nëse radiodifuzeri ka kryer shkelje të tilla serioze, dhe atë të paktën tri herë gjatë kohëzgjatjes së lejes.

17 Komunikatë e SHGM-së, [SHGM me propozime konkrete për servisin publik në seancën e parë publike të Këshillit Programor të RTM-së](#), 12.09.2025.

18 Të gjitha këto çështje janë trajtuar në detaje në analizën me titull "Pasqyrë e kuadrit ligjor të servisit publik radiodifuziv RTM në lidhje me rolin, kompetencat, pavarësinë dhe financimin, nga aspekti i së drejtës së BE-së dhe standardeve dhe praktikave evropiane mediatiche". Kjo analizë iu dorëzua Ministrisë kompetente për Shoqërinë Informatike dhe Administratën në fund të vitit 2023 nga ekipi i ekspertëve të angazhuar në projekt. „[BE për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar për media me të drejtën e BE-së dhe standardet evropiane të mediave](#)“.

19 Mjetet shpërndahen në këtë mënyrë: 80 për qind për RTM-në për mbulimin e kostove të krijimit dhe transmetimit të programeve dhe për zhvillimin teknik-teknologjik, 15 për qind për NP "Radiodifuzioni Maqedonas" për mirëmbajtjen, përdorimin dhe zhvillimin e rrjetit publik radiodifuziv dhe 5 për qind për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

20 Radio Televizioni i Maqedonisë, ["Strategjia pesëvjeçare për zhvillimin e RTM-së"](#), Shkup, 2021.

planifikohen për më shumë se një vit. Mjetet shitesë për zhvillim teknologjik mund, por nuk është e detyrueshme, të ndahen nga Buxheti, gjë që lë hapësirë për ndikim arbitrar nga ana e Qeverisë. Ekziston rreziku që kuadri i ri të mos zbatohet në mënyrë të qëndrueshme, gjë që tashmë u pa në vitin 2023, kur Qeveria nuk e zbatoi plotësisht formulën e re të miratuar. Në vitin 2023, në vend të 18,5 milionë eurove të parashikuara me ligj, u transferuan vetëm 10,9 milionë euro, duke rezultuar në një borxh mbi 2 milionë euro për RTM-në.

Radio Televizioni i Maqedonisë funksionoi për gjashtë vjet me të njëjtin përbërje të Këshillit Programor, edhe pse mandatet e anëtarëve të tij kishin skaduar. Mandatet kishin skaduar edhe për organet e tjera: Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i RTM-së. Në maj të vitit 2025, Komisioni Kuvendor për Zgjedhje dhe Emërime miratoi propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Programor të Radio Televizionit të Maqedonisë. Në periudhën para zgjedhjes, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), së bashku me organizata të tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare, paralajmëroi publikisht për rreziqet e partizimit dhe mungesën e transparencës në procedurë, duke theksuar se përzgjedhja duhet të bazohet në kriteret e qarta profesionale dhe integritetin e kandidatëve.²¹ Pas zgjedhjes, disa nga këto shqetësime vazhduan të shfaqen në publik, përfshirë edhe përmes dyshimeve të shprehura për ndikime të mundshme politike në punën e Këshillit, si dhe përmes vërejtjeve të caktuara për vonesa institucionale në proceset kyçe. Gjatë gjashtë muajve të parë të mandatit, Këshilli Programor u përball me sfida serioze në funksionimin e tij, përfshirë vonesat në zgjedhjen e Bordit Mbikëqyrës dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të RTM-së, gjë që e thelloi më tej pasigurinë institucionale dhe hapi debat mbi efikasitetin, pavarësinë dhe llogaridhënien e servisit publik.

— A.4 MBËSHTETJE FINANCIARE PËR GAZETARI CILËSORE DHE PËRMBAJTJE MEDIATIKE ME INTERES PUBLIK

Në mars të vitit 2024, mbështetja financiare për shtypjen dhe shpërndarjen e mediave të shtypura u rregullua me ndryshime në Ligjin për Media. Në vitin 2025, Qeveria shpalli një thirrje publike²² për mbështetjen e shtypjes dhe shpërndarjes së mediave të shtypura me karakter të përgjithshëm dhe informativ. Mjetet për këtë mbështetje ishin në vlerë prej 10 milionë denarësh, që është afërsisht e njëjtë me shumat e viteve të mëparshme. Komisioni për shpërndarjen e fondeve përbëhej nga përfaqësues të institucioneve përkatëse, si dhe nga një përfaqësues nga Asociacioni për Mbrojtjen e Mediave të Shkruara Kombëtare dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). Nga shuma totale, 2 milionë denarë ishin të destinuar për mediat e shtypura në nivel lokal, ndërsa 8 milionë denarë për mediat e shtypura në nivel

21 Komunikatë e SHGM-së, "[SHGM me propozime konkrete për servisin publik në seancën e parë publike të Këshillit Programor të RTM-së](#)", 12.09.2025.

22 [Thirrje publike](#) për mbështetje për shtypjen dhe shpërndarjen e mediave të shtypura për vitin 2025.

kombëtar. SHGM vlerësoi se procesi i shpërndarjes së fondeve ishte i drejtë, transparent dhe jodiskriminues.

Në vend ende nuk është krijuar një Fond për pluralizëm për mbështetjen e prodhimit të përmbajtjeve mediatike me interes publik, megjithëse ka iniciativa për krijimin e tij. Në kuadër të projektit për reforma mediatike, të mbështetur nga Bashkimi Evropian në vitin 2023, u përgatit një draft për një Ligj të ri për Media, i cili përfshin dispozita për krijimin e një fondi të tillë. Përveç këtij projektligji, SHGM ka publikuar edhe një raport²³ me fokus të veçantë në fondin për pluralizmin e përmbajtjeve mediatike. Për më tepër, në raportin²⁴ nga Misioni për Vlerësimin e Gjendjes së Lirisë së Mediave ofrohen zgjidhje konkrete të zbatueshme në kontekstin kombëtar, veçanërisht duke qenë se kjo është një detyrim i shtetit sipas Rekomandimit CM/Rec(2018)1 për pluralizmin mediatik dhe transparencën e pronësisë së mediave nga viti 2018 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës²⁵. Rekomandimi e zgjeron kërkesën për pluralizëm mediatik edhe në epokën digjitale dhe u bën thirrje në mënyrë eksplicite vendeve anëtare të krijojnë mekanizma të qëndrueshëm dhe transparentë për financim publik, skema të pavarura mbështetëse dhe masa për mbrojtjen e mediave lokale dhe atyre të pakicave.

Përveç programeve radio-televizive në gjuhët e komuniteteve etnike brenda kuadrit të servisit publik radiodifuziv, nuk ekzistojnë mekanizma të tjerë për financimin e mediave në gjuhët e komuniteteve të ndryshme etnike. Këto media nuk janë tërheqëse për reklamuesit dhe prej vitesh përballen me vështirësi financiare. Mungesa e një politike të përshtatshme mediatike për zgjidhjen e këtij problemi reflektohet negativisht në pamjen e përgjithshme pluraliste të sektorit mediatik në vend.

— A.5 REKLAMIMI SHTETËROR NË SEKTORIN PRIVAT TË MEDIAS

Në vitin 2025 hynë në fuqi ndryshimet në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nga shkurti i vitit 2024, me të cilat u hoq ndalimi i reklamimit shtetëror në sektorin mediatik audiovizual. Sipas dispozitave të reja ligjore, Qeveria është e obliguar që gjatë një viti kalendarik të realizojë të paktën një fushatë në nivel shtetëror, përkatësisht të ndajë të paktën 0,1 për qind nga të ardhurat tatimore të realizuara, të përcaktuara në llogarinë përfundimtare të fundit të miratuar të Buxhetit të RMV-së. Nga këto mjete, më së shumti 7% janë për përzgjedhjen e shtëpive prodhuese për hartimin dhe prodhimin e zgjidhjeve kreative dhe realizimeve përfundimtare të fushatave shtetërore, ndërsa të paktën 93% janë për mediat që do t'i realizojnë (publikojnë) këto fushata.

Mjetet për realizimin e fushatave shtetërore shpërndahen ndërmjet mediave si vijon: 40% për televizionet në nivel

23 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "[Të drejtat e gazetarëve, liria e shprehjes dhe pavarësia e mediave në Maqedoninë e Veriut – Raport i meta të dhënave për vitin 2023](#)", Shkup, 2025.

24 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "[Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: Përparim mbi këmbë të qelqta](#)". Raport nga Misioni për Vlerësimin e Gjendjes së Lirisë së Mediave, Shkup 2025.

25 [Recommendation CM/Rec\(2018\)1\[1\]](#) of the Committee of Ministers to member States on media pluralism and transparency of media ownership (Adopted by the Committee of Ministers on 7 March 2018 at the 1309th meeting of the Ministers' Deputies).

shtetëror që transmetojnë përmes operatorit të multipleksit digjital tokësor, 40% për televizionet në nivel shtetëror që transmetojnë përmes operatorëve kabllorë ose satelitorë, 15% për televizionet në nivel rajonal dhe lokal që transmetojnë përmes multipleksit tokësor ose kabllor, si dhe për radiot në nivel lokal dhe rajonal, dhe 5% për radiot në nivel shtetëror.^{26 27}

Komunat, nga ana tjetër, mund të financojnë deri në katër fushata në vit, për të cilat mund të ndajnë më së shumti deri në 0,5% të buxhetit komunal, përkatësisht nga të ardhurat e veta tatimore të realizuara, të përcaktuara në llogarinë përfundimtare të fundit të miratuar. Shpërndarja e mjeteve bëhet si vijon: më së shumti 10% janë për përzgjedhjen e shtëpive prodhuese për hartimin dhe prodhimin e zgjidhjeve kreative dhe realizimeve përfundimtare të fushatave shtetërore në nivel lokal, ndërsa të paktën 90% janë për realizimin e fushatave në nivel lokal.

Shoqatat e gazetarëve (SHGM dhe SPGPM), ekspertët dhe disa institucione relevante (Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Enti Shtetëror i Revizionit dhe Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale) në vazhdimësi kundërshtojnë shpenzimin e parave publike për reklamim shtetëror dhe politik, duke theksuar se këto mekanizma kompleksë financiarë e rrezikojnë pavarësinë e mediave, e deformatojnë tregun mediatik dhe përbëjnë burim të korrupsionit dhe klientelizmit.

Në vitin 2025, zbatimi në nivel qendror dhe lokal ishte objekt monitorimi nga SHGM. Sipas analizës së transparencës së njësisive të vetëqeverisjes lokale për shpenzimin e mjeteve publike në media²⁸, asnjë komunë nuk ka zbatuar procedurë për miratimin e fushatave nga ana e Këshillit komunal, që është parakusht për transparencë dhe llogaridhënie. Një pjesë e madhe e kontratave lidhen pa një metodologji të qartë ose pa debat publik. Disa komuna lidhin kontrata me agjenci marketingu ose persona fizikë, dhe jo drejtpërdrejt me media, gjë që vlerësohet si jotransparente dhe si shmangie e rregullimit mediatik. Disa komuna kanë disa kontrata me më shumë media, ndërsa të tjera nuk lidhin fare kontrata ose nuk u përgjigjen kërkesave për transparencë.

Disa kontrata mbulojnë prodhimin e “ngjarjeve publike” ose “njoftimeve të komunës”, por përmbajtja e publikuar shpesh është në funksion të promovimit pozitiv të kryetarit të komunës ose të pushtetit lokal, pa një dallim të qartë ndërmjet informimit me interes publik dhe përmbajtjes promovuese. Rrallëherë ndonjë komunë publikon informacione të detajuara për kontratat e lidhura, mjetet e shpenzuara apo efektet e fushatave të realizuara.

26 [Financimi shtetëror në Maqedoninë e Veriut](#): Sistem më i DREJTË, më i FORTË dhe më TRANSPARENT, shkurt 2025. Fondacioni Metamorfozis, 2025.

27 [Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale](#), Tekst i konsoliduar redaksional, Ministria e Transformimit Digjital, 2024.

28 SHGM, [“Analizë: Transparenca e njësisive të vetëqeverisjes lokale në shpenzimin e mjeteve publike në media”](#), maj 2025.

— A.6 DISPOZITAT LIGJORE QË LIDHEN ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI I TYRE NUK KRIJOJNË EFEKT FRIKËSUES PËR GAZETARËT DHE MEDIAN

Në vitin 2025 pothuajse nuk janë vërejtur efekte negative të rëndësishme nga ndryshimet në Ligjin për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje, të miratuara në nëntor të vitit 2022. Qëllimi i këtyre ndryshimeve – ulja e shumave të parashikuara për dëmshpërblim jomaterial që mund të shqiptojë gjykata, në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në gazetarinë e lirë dhe kritike – u dëshmuoi si i arsyeshëm. Ligji garanton lirinë e shprehjes, ndërsa kufizimet janë në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas të dhënave të Gjykatës Themelore Civile në Shkup, numri i përgjithshëm i lëndëve aktive në katër vitet e fundit është 40. Veçmas, në vitin 2025 janë paraqitur 16 padi të reja për shpifje dhe fyerje kundër gazetarëve dhe/ose mediave. Numri i padive të reja në vitin 2025 u rrit në 16 krahasuar me vitin 2024, kur u regjistruan 15 raste. Edhe pse rritja krahasuar me vitin 2024 është e vogël, këto të dhëna tregojnë se paditë për shpifje dhe fyerje vazhdojnë të mbeten faktor i pasigurisë juridike dhe profesionale për gazetarët dhe mediat. Një pjesë e gazetarëve të intervistuar këtë rritje e perceptojnë " ...si formë presioni të tërthortë dhe përpjekje për heshtje, veçanërisht kur paditë vijnë nga bartës të funksioneve publike ose subjekte të fuqishme ekonomike".²⁹ Gazetarët i përshkruajnë këto procedura edhe si "rraskapitëse" dhe "demotivuese", duke theksuar se, edhe pse një pjesë e padive nuk kanë bazë të fortë juridike, vetë procedura krijon barrë financiare dhe psikologjike.

— A.7 LIGJET E TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE U MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIKË TË PUNOJNË LIRSHËM DHE NË MËNYRË TË SIGURT

Në vend nuk ekziston një mbrojtje ligjore efikase për mediat kritike apo gazetarët nga të ashtuquajturat padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP). Në analizën krahasuese për trajtimin e SLAPP³⁰ në vendet e BE-së dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, e publikuar në vitin 2025 nga SHGM, theksohen boshllëqe serioze në rregulloren kombëtare dhe në praktikën gjyqësore – nga mungesa e mekanizmave të qartë procedurale për hedhjen e hershme poshtë të padive abuzive, deri te mbrojtja e pamjaftueshme e gazetarëve nga presioni financiar dhe psikologjik. Rekomandohen një sërë masash ligjore dhe institucionale që do të mundësonin reagim më të shpejtë të gjykatave dhe parandalim më të mirë të padive SLAPP. Në vitin 2025, pas një iniciative shumëvjeçare të SHGM-së, Qeveria e RMV-së paralajmëroi formimin e një grupi pune që do të merrej me ndryshimet ligjore me

29 Deklaratë e një gazetares redaktore në një medium online, grup fokusi me gazetarë dhe punonjës mediatikë, realizuar nga Milan Spirovski më 26.12.2025.

30 Zharko Aleksov dhe Zharko Haxhi-Zafirov, "Analizë krahasuese për trajtimin e SLAPP në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së përkundrejt Magedonisë së Veriut", Iniciativa për Perspektivë Evropiane (IPE), 2025.

qëllim përfshirjen e dispozitave për mbrojtje nga këto padi, por deri në fund të vitit grupi ende nuk ishte formuar.

Krahasuar me vitin 2024, në vitin 2025 nuk u vërejt rritje e ndjeshme e presionit ndaj gazetarëve hulumtues nga ana e elitës së biznesit. Megjithatë, statistikave të SHGM-së për katër vitet e fundit tregojnë një trend më të gjerë të rritjes së përdorimit të padive SLAPP si mjet frikësimi dhe presioni ndaj gazetarëve hulumtues. Sa i përket vazhdimësisë së këtij problemi, në vitin 2024 vazhduan procedurat gjyqësore për paditë e paraqitura më herët, ndërsa disa prej tyre u shoqëruan me veprime të prokurorisë dhe seanca gjyqësore. Në vitin 2025 u regjistrua një rast i ri i padisë SLAPP ndaj një mediumi hulumtues nga një institucion privat i arsimit të lartë.

Në vitin 2025 nuk u evidentuan shembuj të zbatimit arbitrar apo diskriminues të ligjeve të tjera me qëllim kufizimin e lirisë së punës së gazetarëve apo ngarkimin e mediave me kosto për përfaqësim. Megjithatë, mungesa e mekanizmave anti-SLAPP vazhdon të mbetet një problem kyç sistemor.

— A.8 KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Mbrojtja e burimeve gazetareske është e garantuar dhe e rregulluar në mënyrë të detajuar në Kushtetutën e RMV-së dhe në disa ligje: Ligjin për Media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjin për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje, Kodin Penal dhe Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Gjatë vitit 2025, dispozitat e këtyre ligjeve janë respektuar, përkatësisht SHGM nuk ka evidentuar raste të kufizimit të së drejtës së gazetarëve për mbrojtjen e burimeve.

Gjatë vitit 2025, SHGM nuk ka regjistruar as ankesa për presione ndaj gazetarëve për të zbuluar burimet e tyre konfidenciale, ndërsa gazetarët që punojnë në artikuj hulumtues janë ndier të lirë në kontaktimin me burimet. Megjithatë, numri i individëve që raportojnë raste korrupsioni tek organet kompetente dhe tek gazetarët mbetet ende i ulët, edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve garanton të drejtat e tyre dhe rregullon raportimin e mbrojtur. Në këtë kuptim, burimet gazetareske janë të inkurajuar dhe institucionalisht më mirë të mbrojtura, por për shkak të presioneve dhe frikës për vendin e punës, njerëzit ende rrallë guxojnë ta përdorin këtë mekanizëm.

— A.9 GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË THEMELOJNË, TË BASHKOHEN DHE TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Profesioni i gazetarit nuk i nënshtrohet licencimit, dhe nuk ka pasur përpjekje nga shteti për të vendosur çfarëdo kushtesh për ushtrimin e këtij profesioni. Dispozitat e Ligjit për Media janë tashmë të vjetruara, veçanërisht sa i përket përkufizimit kufizues

të termit "gazetar"³¹. Gazetarët janë të lirë të organizohen në shoqatat e tyre. Gjatë vitit 2025 nuk janë vërejtur presione të drejtpërdrejta politike ndaj shoqatave të gazetarëve si organizata, megjithëse në praktikë vazhduan presionet që lidhen me organizimin sindikal në disa media. SHGM është shoqata kryesore e gazetarëve, e cila funksionon që nga viti 1946 dhe është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve dhe e Federatës Evropiane të Gazetarëve. SHGM është organizatë anëtarësie. Në fund të vitit 2025, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) kishte 479 anëtarë aktivë të regjistruar. Anëtarësia paguhet në baza dyvjeçare.

Aktive janë edhe dy organizata të tjera anëtarësie: Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM) dhe Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM). Gjatë vitit 2025, Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM) funksionoi pa pengesa në trajtimin e ankesave të pranuar për përmbajtje mediatike, promovimin e vetërregullimit mediatik para publikut të gjerë dhe punën me të rinjtë për njohjen dhe demaskimin e dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes. Një karakteristikë e veçantë e vitit të kaluar ishte se brenda një dite në KEMM u paraqitën mbi 140 ankesa lidhur me raportimin për tragjedinë në Koçan (mesatarja vjetore e ankesave të pranuar është rreth 100), gjë që vlerësohet si përpjekje e orkestruar për heshtjen e mediave. Problemi kryesor për KEMM mbetet brishtësia dhe paparashikueshmëria financiare, e cila pengon aktivitetet zhvillimore dhe kërkimore të organizatës.³²

Sfidat kryesore me të cilat përballet Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM) lidhen me presionet kundër organizimit sindikal. Në disa media, përmes formave të ndryshme të presionit të butë, gazetarëve të punësuar dhe profesionistëve të tjerë mediatikë nuk u lejohej të anëtarësohen në SPGPM ose të formojnë një grup sindikal. Këto presione kryesisht vijnë nga menaxhmenti, veçanërisht në televizionet më të mëdha private në nivel kombëtar.

Gjithashtu, anëtarët e SPGPM-së (por edhe anëtarët potencialë) përballen me presione të drejtpërdrejta nga dy sindikata të tjera, në servis publik RTM dhe në agjencinë shtetërore MIA, të cilat, sipas SPGPM-së, funksionojnë si të ashtuquajtura "sindikata të verdha". Këto presione kanë të bëjnë kryesisht me kërcënime për largim nga SPGPM ose me dekurajimin e të punësuarve për t'u anëtarësuar në sindikatë, dhe janë veçanërisht të theksuara në servis publik radiodifuziv.³³

— A.10 E DREJTA PËR QASJE NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONE ZYRTARE

Deri në dhjetor të vitit 2025, në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik janë paraqitur 354 ankesa nga kërkues të informacionit, prej

31 Në nenin 2 të "Ligjit për Media", termi gazetar përkufizohet si "person që mbledh, analizon, përpunon ose klasifikon informacione të publikuara në media dhe është i punësuar në media ose ka kontratë pune me to, ose person që ushtron veprimtari gazetareske si profesionist i pavarur (gazetar i lirë)".

32 Intervistë me Biljana Georgievska, drejtore të Ekzekutivës së Këshillit të Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM).

33 Intervistë me Darko Duridanski, menaxher programi në Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM).

të cilave 36 nga gazetarë. Këto të dhëna tregojnë se numri i ankesave të paraqitura nga gazetarët mbetet relativisht i ulët (në vitin 2024, nga 454 ankesa, 37 ishin nga gazetarë). Gazetarët që merren me gazetari hulamtuese ankohen se institucionet shpesh nuk i respektojnë afatet, por theksojnë gjithashtu se, ndryshe nga më parë, Agjencia ka treguar mirëkuptim më të madh dhe u ofron ndihmë në përdorimin e ligjit³⁴. Megjithatë, gjatë vitit 2025, SHGM evidentoi probleme serioze në funksionimin e Agjencisë: nga 24 dhjetori 2025, Agjencia mbeti pa drejtor dhe zëvendësdrejtor të emëruar, për shkak të së cilës praktikisht nuk mund të ushtronte plotësisht kompetencat e saj ligjore. Si pasojë e kësaj gjendjeje, një pjesë e ankesave të paraqitura nga gazetarët dhe qytetarët mbetën pa përgjigje ose pa zgjidhje, ndërsa edhe në rastet kur procedura ishte përfunduar, vendimet nuk mund të dërgoheshin për shkak të mungesës së një personi të autorizuar për t'i nënshkruar. Kjo boshllëk institucional krijoi rrezik për kufizimin e të drejtës për qasje në informacionet me karakter publik dhe mundësi që disa institucione ta shmangin transparencën, duke ditur se nuk ka kush t'i shqyrtojë ankesat në kohë.

Në gjysmën e dytë të vitit 2024, Ministria e Drejtësisë formoi një grup pune për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, në të cilin anëtarë aktivë janë edhe përfaqësues të SHGM-së. Grupi i punës mbajti rreth dhjetë takime dhe përgatiti një propozim për ndryshime në Ligj, i cili u dorëzua në Kuvend, por deri në fund të vitit 2025 ky projektligj nuk u vendos në rendin e ditës së organeve kuvendore.

Sipas analizave të mëparshme të SHGM-së³⁵, gazetarët vlerësojnë se sistemi gjyqësor është më i hapur dhe më transparent se në të kaluarën. Këto zhvillime pozitive, megjithatë, nuk janë rezultat i një përmirësimi sistemik, i miratimit të një strategjie apo i zbatimit të reformave në drejtim të rritjes së transparencës së gjyqësorit, por më shumë i sjelljes së individëve brenda sistemit gjyqësor për të rritur transparencën e institucioneve që përfaqësojnë. Në drejtim të përmirësimit të transparencës, SHGM prej vitesh thekson edhe nevojën për krijimin e një regjistri të zëdhënësve të institucioneve gjyqësore, i cili duhet të jetë publikisht i disponueshëm në faqet e internetit të gjykatave dhe në faqen www.sud.mk. Një regjistër i tillë do të ishte një mjet praktik për rritjen e transparencës institucionale dhe për lehtësimin e qasjes së gazetarëve në informacione të sakta dhe në kohë.

Sa i përket transparencës së Kuvendit dhe komunikimit të partive politike dhe deputetëve me gazetarët në vitin 2025, "gazetarët që raportojnë nga Kuvendi i RMV-së nuk ishin plotësisht dhe në mënyrë objektive të informuar nga koordinatorët e grupeve parlamentare për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, veçanërisht për mosmarrëveshjet ndërmjet pushtetit dhe opozitës apo ndërmjet kryetarit të

34 Për nevojat e këtij Raporti janë realizuar pesë intervista me gazetarë që merren me gazetari hulamtuese gjatë vitit 2025.

35 Pashovski, Davor, "Qëndrimet dhe perceptimet e gazetarëve për transparencën e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut", Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shkup, 2021.

Kuvendit dhe një grupi të caktuar parlamentar”³⁶. Publiku ka mundësi që përmes Kanalit të Kuvendit ta ndjekë drejtpërdrejt punën e deputetëve dhe miratimin e ligjeve. Megjithatë, edhe pse ka rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve, Kanali i Kuvendit në thelb shërben kryesisht si shërbim teknik për transmetimin e aktiviteteve parlamentare, pa prodhim më të gjerë gazetaresk apo përmbajtje analitike.³⁷

36 Deklaratë e një gazetareshe, redaktore në një medium online – pjesëmarrëse në një fokus grup të organizuar nga Milan Spirovski për nevojat e përgatitjes së këtij raporti, më 26.12.2025.

37 Shih më shumë në faqen e internetit të [Kuvendit](#).

B. POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSI

— B.1 POZITA E PUNËS E GAZETARËVE ËSHTË E QËNDRUESHME DHE E MBROJTUR NË VENDIN E PUNËS

Megjithëse marrëdhënia e punës për shumicën e gazetarëve konsiderohet formalisht e qëndrueshme, realiteti i përditshëm i punës tregon një pasqyrë tjetër. Respektimi i orarit ligjor të punës vihet më shpesh në pikëpyetje në mediat private sesa në servis publik radiodifuziv³⁸. Mbi kufirin e lejuar ligjor punojnë 28% e gazetarëve dhe 14% e punonjësve të medias, ndërsa ngarkesa e tepërt në punë shndërrohet në burim të drejtpërdrejtë të stresit kronik. Më shumë se gjysma e gazetarëve (55%) kanë deklaruar se shumë shpesh ose shpesh ndiejnë presion psikologjik nga detyrimet e punës, në krahasim me 31% të punonjësve të medias³⁹.

Sa i përket stabilitetit të statusit të punës, të dhënat kërkimore tregojnë se rreth 70% e gazetarëve dhe punonjësve të medias kanë pasur kontrata pune me kohë të pacaktuar dhe me orar të plotë, rreth 17% kanë qenë të angazhuar me kontrata me kohë të caktuar, ndërsa 7% përkatësisht 9% me kontratë për vepër ose kontratë autoriale⁴⁰. Angazhime të tilla (të përkohshme ose të paqëndrueshme pune) janë më të shpeshta në sektorin online, e më pas në mediat e shtypura dhe në televizionet private.

Problemi më i madh mbetet vlerësimi i punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias në vendin e tyre të punës. Gjatë dy viteve të fundit, rreth 50% e gazetarëve dhe 77% e punonjësve të medias kanë pasur të ardhura nën pagën mesatare mujore në RMV, e cila në atë periudhë ishte 37.065,00 denarë. Gjatë vitit 2025, gjendja është përkeqësuar, duke pasur parasysh se pak gazetarë konfirmojnë se pagat ndjekin trendin e rritjes së pagës mesatare në vend. Një problem tjetër serioz është se në shumë raste mediat nuk u paguajnë të punësuarve kompensim për orët shtesë ose për punën gjatë festave.

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM) është sindikata e vetme kombëtare që i bashkon gazetarët dhe punonjësit e medias në vend. Në fund të vitit 2025, SPGPM numëronte rreth 500 anëtarë aktivë. Vitin e kaluar u regjistruan presione të buta ndaj drejtuesve dhe anëtarëve të SPGPM-së, të lidhura me anëtarësimin e gazetarëve në sindikatë, por edhe me qëndrimin e SPGPM-së kundër heqjes së ndalimit të reklamimit shtetëror në mediat private audiovizuale. Edhe në vitin 2025 nuk është nënshkruar një marrëveshje kolektive e përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve në mediat private. SPGPM ka nënshkruar marrëveshje kolektive vetëm me Agjencinë Informative Mediatike (MIA), e cila është në pronësi shtetërore.⁴¹ Në vitin 2025, grupi sindikal i SPGPM-së në RTM punoi për përmirësimin

38 Tërpevska, Snezhana "Kushtet e punës në sektorin mediatik: "Statusi profesional dhe të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias", SPGPM, Instituti RESIS, Shkup, 2024.

39 Ibid, faq.17.

40 Ibid.

41 Intervistë me Darko Duridanski, koordinator projekti në Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM), 22 janar 2026.

e kushteve të punës së gazetarëve në servis publik dhe zhvilloi edhe një takim pune me Këshillin Programor të RTM-së.⁴²

— B.2 PAVARËSIA REDAKTUESE NË MEDIAT PRIVATE

Nuk ekzistojnë të dhëna të publikuara nga të cilat mund të përcaktohet nëse dhe sa media private kanë akte të brendshme organizative ose rregulla sipas të cilave kolegji i redaktues është edhe formalisht i ndarë nga menaxhmenti i medias. Megjithatë, sipas dëshmimeve të gazetarëve përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, mund të konkludohet se akte të tilla rrallë ekzistojnë. Nuk ka informacione nëse ndonjë nga mediat private ka miratuar kode etike ose rregulla të veçanta të veta. I vetmi kod që vlen për të gjithë gazetarët profesionistë, në cilindo sektor mediatik, është Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë⁴³, i miratuar në vitin 2001. Kodi është bazë për veprimin edhe të Këshillit të Nderit të SHGM-së dhe të Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM).⁴⁴ KEMM ka miratuar edhe Udhëzime për raportim etik në mediat online, përkatësisht udhëzime për zbatimin e Kodit të Gazetarëve në sferën online⁴⁵.

Lidhja ndërmjet pronarëve të disa mediave dhe qendrave të pushtetit shpesh është në dëm të gazetarëve që punojnë në këto media. Në fokus grupin me gazetarë dhe gazetare dhe punonjës mediatikë të organizuar nga SHGM⁴⁶ për nevojat e këtij raporti, pjesëmarrësit theksuan se shpesh nuk i raportojnë dhe nuk dinë ku t'i raportojnë presionet, kërcënimet dhe komentet ndaj tyre dhe punës së tyre.

“Kur bëhet fjalë për presione, ne si gazetarë, përveç te SHGM dhe SPGPM, nuk kemi ku të raportojmë se jemi objekt i fenomeneve të tilla”⁴⁷. Përndryshe, presionet më së shpeshti nuk shprehen si kërcënime të drejtpërdrejta, por përmes një sërë mënyrash të buta ndikimi, veçanërisht përmes pasigurisë së statusit të punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias.

— B.3 PAVARËSIA REDAKTUESE NË SERVISIN PUBLIK MEDIATIK

Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM) që nga viti 2017 ka miratuar një Kod etik⁴⁸, i cili vlen për stafin kreativ dhe për të gjithë të punësuarit në RTM. Kodi që në fillim u përball me kritika nga komuniteti i gazetarëve, si për përmbajtjen e tij, ashtu edhe për mungesën e transparencës gjatë hartimit. Mangësia më e madhe e Kodit është përzierja e etikës gazetareske me disiplinën e punës dhe me të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Komisioni etik pranë

42 [SPGPM dhe grupi sindikal i RTM-së pranë SPGPM-së në takim me Këshillin Programor të Radio Televizionit të Maqedonisë](#), 20.11.2025.

43 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “[Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë](#)”.

44 Me [iniciativë të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë](#) (SHGM), Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM) dhe Instituti Maqedonas për Media (IMM), filluan procesin e konsultimeve për hartimin e një kodi të ri etik për gazetarët dhe mediat. Kodi i ri do të zëvendësojë versionin ekzistues të vitit 2001, me qëllim që të reflektojë sfidat dhe nevojat bashkëkohore të komunitetit gazetaresk dhe mediatik. Si mbështetje e procesit janë përgatitur dy dokumente të rëndësishme, të cilat ofrojnë bazë analitike dhe udhëzime për modernizimin e standardeve etike në gazetari.

45 Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedonisë, “[Udhëzime për raportim etik në mediat online – Zbatim i Kodit të Gazetarëve në sferën online](#)”.

46 Fokus grup me gazetarë dhe punonjës mediatikë, realizuar nga Milan Spirovski më 26.12.2025.

47 Deklaratë e një gazetari, pjesëmarrës në fokus grupin me gazetarë të mbajtur më 26.12.2025.

48 Radio Televizioni i Maqedonisë, “[Kodi etik i RTM-së për gazetarët, stafin kreativ dhe të gjithë të punësuarit në RTM](#)”, Shkup, 2017.

RTM-së, i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit, nuk ka pranuar asnjë ankesë gjatë periudhës së kaluar.

SHGM, në vitin 2021, bëri thirrje për ndryshimin e Kodit etik të RTM-së dhe për përcaktimin e procedurave për paraqitjen e ankesave dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit etik, të cilat duhet të publikohen edhe në faqen e internetit të RTM-së. Gjatë vitit 2025, përbërja e re e Këshillit Programor të RTM-së nisi aktivitete lidhur me këtë çështje, në bashkëpunim me organizatat profesionale mediatike dhe publikun ekspert,⁴⁹ që mund të vlerësohet si një hap fillestar pozitiv në drejtim të tejkalimit të dobësive të evidentuara.

RTM ka akte të brendshme, sipas të cilave redaksitë janë edhe formalisht të ndara nga strukturat drejtuese. Megjithatë, në faqen e internetit të RTM-së vështirë mund të gjenden informacione për rregullat e organizimit të brendshëm dhe për funksionimin e organeve dhe trupave të saj. RTM ende nuk është e çliruar nga ndikimet sistematike politike.⁵⁰, edhe pse rregullorja ekzistuese është e dizajnuar për të siguruar pavarësinë në përzgjedhjen e organeve dhe trupave të RTM-së dhe financimin e saj të qëndrueshëm dhe të pavarur. Në vitet e fundit, përfshirë edhe vitin 2025, nuk janë regjistruar presione të drejtpërdrejta nga pushteti ndaj redaksive apo ndaj gazetarëve individualë, por më tepër bëhet fjalë për forma strukturore presioni: përmes vonësive në zgjedhjen e organeve të reja të RTM-së. Në dhjetor të vitit 2025, Këshilli Programor i Ndërmarrjes Publike Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM) e informoi publikun⁵¹ se Propozim-Statuti i RTM-së vihet në debat publik në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke filluar nga dita e publikimit të tij në faqen e internetit të RTM-së. Në kuadër të debatit publik, të gjitha palët e interesuara, institucionet, organizatat profesionale dhe qytetare, punonjësit mediatikë dhe qytetarët do të kenë mundësi të paraqesin mendimet, komentet dhe propozimet e tyre lidhur me tekstin e Propozim-Statutit.

— B.4 PAVARËSIA REDAKTUESE NË SEKTORIN MEDIATIK JOFITIMPRURËS

Mediat jofitimprurëse në vend nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm, para së gjithash për shkak të mungesës së politikave për mbështetje dhe financim të këtij sektori.⁵² Edhe pse rregullatori mediatik ka miratuar një dokument të veçantë për politika⁵³ për zhvillimin e sektorit jofitimprurës të radiodifuzionit, deri vitin e kaluar ekzistonin vetëm dy radio jofitimprurëse – një radio e dedikuar për komunitetet studentore në universitetin shtetëror në Manastir (UKLO FM) dhe një radio e dedikuar për komunitetin fetar në Strumicë (Radio Maria Blagovest).

49 [SHGM me propozime konkrete për servis publik në seancën e parë publike të Këshillit Programor të RTM-së](#), 12.09.2025.

50 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, [Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: Përpamim mbi këmbë të qelqta, Raport nga Misioni për Vlerësimin e Gjendjes së Lirisë së Mediave](#), Shkup, 5-7 qershor 2023.

51 [Thirrje publike](#) në Këshillin Programor të RTM-së për ndryshimin e një Statuti të ri, 25.12.2025.

52 Micevski, Igor; Tërpevska, Snezhana. „[Monitorimi i pluralizmit mediatik në epokën digjitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit Mediatik në Bashkimin Evropian, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Turqi – Raporti kombëtar: Republika e Maqedonisë së Veriut](#)”, Instituti Universitar Evropian, qershor 2023.

53 Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, [Koncept për zhvillimin e institucioneve jofitimprurëse të radiodifuzionit](#), dhjetor, 2015.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të mediave jofitimprurëse në sektorin online në vend. Disa redaksi të pavarura gazetareske, të regjistruara si shoqata qytetare, merren me gazetari hulumtuese: Prizma, IRL, 360 stepeni, SKUP Maqedoni⁵⁴ dhe të tjera. Organizata të tjera joqeveritare, si pjesë e projekteve të tyre programore, kanë themeluar edhe media informative, të destinuar për audiencë të ndryshme: Portalb, Radio MOF, Meta.mk, Jasno.mk, Lokal Aktiv⁵⁵ dhe të tjera. Redaksitë e mediave jofitimprurëse zakonisht janë të vogla dhe përfshijnë disa gazetarë, ndërsa financimi i tyre është i paqëndrueshëm dhe jo i qëndrueshëm.

Në prill të vitit 2025 u bë një hap i rëndësishëm, pasi mediat online dhe portalet e internetit u njohën në Ligjin për Media⁵⁶. Ky ndryshim është i rëndësishëm sepse portalet dhe gazetarët tani do të mund ta kërkojnë më lehtë mbrojtjen e tyre. Vendosja e Regjistrimit të botuesve të mediave online pranë ASHMAAV⁵⁷ paraqet një hap pozitiv drejt rritjes së transparencës dhe profesionalizimit. Me iniciativë të Ministrisë së Transformimit Dixhital, me ndryshimet e fundit në Ligjin për Media, portalet e internetit, përfshirë edhe ato jofitimprurëse, për herë të parë njihen si media me të drejta dhe obligime përkatëse.

Nuk ekziston një kod i veçantë i sjelljes për gazetarët në sektorin jofitimprurës, por në vitin 2021, Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë (KEMM) miratoi Udhëzime për raportim etik në mediat online⁵⁸, të cilat në fakt e shtjellojnë më hollësisht zbatimin e parimeve themelore etike të Kodit të Gazetarëve në sferën online. Përveç kësaj, KEMM dhe SHGM formuan Regjistrin e mediave profesionale online⁵⁹ Promedia, në të cilin anëtarësohen rreth 116 media informative online, përfshirë edhe një pjesë të mediave jofitimprurëse. Pjesa më e madhe e këtyre mediave e kanë pranuar Kodin Etik dhe Udhëzimet për raportim etik në mediat online, zbatimin e të cilave mbikëqyret nga KEMM⁶⁰.

Edhe pse presioni ndaj mediave jofitimprurëse, veçanërisht atyre që merren me gazetari hulumtuese, është zvogëluar në krahasim me periudhën para 10 vitesh, kur gazetarët dhe redaktorët e këtyre mediave shpesh diskreditohehin dhe sulmoheshin ashpër në publik për shkak të shkrimeve kritike ndaj pushtetit të atëhershëm dhe qarqeve të fuqishme, vlerësimet e pjesëmarrësve në grupin fokal janë se perceptimi është që në tre vitet e fundit ka sërish rritje të presioneve, veçanërisht e dukshme përmes paraqitjes së padive për shpifje dhe fyerje.

54 [Prizma](#) është një faqe interneti e BIRN Maqedoni, e dedikuar për promovimin dhe forcimin e gazetarisë hulumtuese. [Laboratori i Gazetarisë Hulumtuese](#) (IRL) është një organizatë mediatike jofitimprurëse, raportimi i së cilës është i fokusuar në korrupsion, krim dhe qeverisje të mirë. [SKUP](#) Maqedoni është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, qëllimi i së cilës është të avancojë, mbështesë dhe nxisë gazetarinë hulumtuese.

55 [Portalb](#) është një media jofitimprurëse në gjuhën shqipe, e themeluar nga organizata joqeveritare Media Inovative, qëllimi i së cilës është të avancojë praktikën gazetareske. [Radio MOF](#) është një aktivitet programor i Forumit Arsimit Rinor. [Meta.mk](#) është një agjenci e pavarur lajmesh, e cila është projekt i Fondacionit "Metamorphosis". [Jasno.mk](#) është një platformë digjitale, e themeluar nga SHGM, me qëllim rritjen e vetëdijes dhe forcimin e kapaciteteve të komuniteteve lokale për të identifikuar dezinformatat, veçanërisht ato me bazë gjinore. [Lokal aktiv](#) është një media online e komuniteteve lokale, përfshirë edhe grupet e cënueshme të qytetarëve dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë me to, e themeluar nga Instituti RESIS në partneritet me 22 organizata qytetare nga [rajoni lindor dhe juglindor](#) dhe 10 organizata qytetare nga [rajoni i Vardarit](#).

56 [Ligji për Media](#), tekst i konsoliduar, Ministria e Transformimit Digjital.

57 [SHGM alarmon: Mungesa e rregullave për reklamim politik të paguar në mediat online krijon rreziqe për korrupsion](#), 15.08.2025.

58 Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë (KEMM), [Udhëzime për raportim etik në mediat online](#).

59 Regjistri i mediave profesionale online në Republikën e Maqedonisë së Veriut [PROMEDIA](#).

60 Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë, [„Udhëzime për raportim etik në mediat online – Zbatimi i Kodit të Gazetarëve në sferën online“](#).

— B.5 LIRIA E GAZETARËVE NË PROCESIN E PRODHIMIT TË LAJMEVE

Një problem që gazetarët e theksojnë shpesh është ndikimi i një pjese të redaktorëve në punën e tyre të përditshme, por ky ndikim nuk është aq i drejtpërdrejtë dhe i dukshëm, pra ka më shumë vetëcensurë sesa presione direkte. Bëhet fjalë për faktin se në redaksi paraprakisht dihet cilat tema janë të pranueshme, përkatësisht cilat tema redaktori do t'i pranojë dhe cilat do t'i refuzojë. Gazetarët që ishin të përfshirë në hulumtimin e realizuar për vitin 2025⁶¹ vlerësojnë se kanë liri në përzgjedhjen e temave në procesin e prodhimit të lajmeve: "Gjatë vitit të kaluar, të paktën në redaksinë tonë, asnjëherë nuk kemi pasur pengesa apo vërejtje lidhur me temat në të cilat gazetarët punojnë ose do të punojnë, gjithmonë kemi hasur në mbështetje"⁶². Kjo vlen veçanërisht për mediat që kanë redaksi më të mëdha. Megjithatë, përzgjedhja e temave për raportim është një problem më i madh për gazetarët në mediat rajonale dhe lokale. "Shkaku i këtij problemi është mjedisi i vogël në të cilin funksionojnë këto media, lidhjet klienteliste të vendosura të pronarëve me kryetarët e komunave dhe aktorë të tjerë lokalë me ndikim, si dhe gjendja e dobët financiare në të cilën ndodhen këto media"⁶³.

Edhe pse numri i mediave hulumtuese është i vogël, mjedisi politik tani më shumë mundëson punë gazetareske hulumtuese. Në përgjithësi, gazetarët punojnë në një atmosferë më të hapur dhe më të lirë krahasuar me dekadën e kaluar dhe ndihen më të lirë të hulumtojnë dhe të raportojnë për çështje komplekse, siç është korrupsioni. Megjithatë, duket se në komunitetin më të gjerë gazetaresk ende ekziston shumë vetëcensurë për shkak të frikës nga pasojat politike ose ligjore. Sipas vlerësimit të bërë nga disa ekspertë ndërkombëtarë, gjendja e gazetarisë së pavarur dhe liria redaktuese vazhdojnë të jenë problematike, pasi "...shumë pronarë mediash, veçanërisht në mediat tradicionale (stacionet kombëtare televizive), kanë biznese të tjera kryesore, të cilat shpesh varen nga tenderët e ministrive dhe institucioneve, duke krijuar tema tabu të nënkuptuara ose të shprehura"⁶⁴.

— B.6 POZITA EKONOMIKE E GAZETAREVE

Rezultatet e analizave dhe hulumtimeve të realizuara gjatë dy viteve të fundit⁶⁵ tregojnë se hendeku në paga mbi bazë gjinore pothuajse nuk ekziston në sektorin mediatik, por të ardhurat e ulëta mbeten një sfidë sistematike. Më shumë se gjysma e gazetarëve dhe një pjesë e konsiderueshme e punonjësve mediatikë fitojnë nën pagën mesatare mujore në nivel shtetëror, ndërsa situata është veçanërisht e pafavorshme në sektorin privat. Edhe pse rregullsia e pagesave në përgjithësi nuk paraqet problem, është e përhapur gjerësisht praktika

61 Deklaratë e një gazetareshe pjesëmarrëse në një grup fokusi të mbajtur më 26.12.2025.

62 Deklaratë e një gazetari pjesëmarrës në një grup fokusi të mbajtur më 26.12.2025.

63 Deklaratë e një gazetareshe-redaktore në televizion, pjesëmarrëse në një grup fokusi të mbajtur më 26.12.2025..

64 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), "[Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: Përparim mbi këmbë të qelqta](#)", Raport nga Misioni për vlerësimin e gjendjes së lirisë së mediave, Shkup, 2024.

65 Tërpevska, Snezhana, "[Kushtet e punës në sektorin mediatik: 'Statusi profesional dhe të drejtat e punës të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë'](#)", SPGPM, Instituti RESIS, Shkup, 2024.

që të mos paguhen kompensimet për punë jashtë orarit dhe për punë gjatë festave. Të dhënat gjithashtu tregojnë se gratë nuk janë në pozitë të pafavorshme sa i përket zhvillimit të karrierës dhe përfaqësimit në pozita redaktuese, me një përfaqësim pothuajse të barabartë gjinor në strukturat redaktuese, veçanërisht në sektorin e radiodifuzionit⁶⁶.

Nuk ekzistojnë të dhëna më të reja hulumtuese nëse gazetaret dhe punonjëset mediatike janë të ekspozuara ndaj sulmeve, presioneve dhe ngacmimeve mbi bazë gjinore. Megjithatë, disa gazetarë deklarojnë se shpesh janë të ekspozuara ndaj komenteve me karakter seksist, presioneve ose fyerjeve, vetëm për faktin se janë gra⁶⁷. Edhe pse të dhënat nuk tregojnë një nënshtrim të theksuar të grave sa i përket zhvillimit të karrierës dhe përfaqësimit në pozita redaktuese, kjo nuk do të thotë se gazetaret janë të liruara nga forma specifike gjinore të presionit dhe ngacmimit, veçanërisht në hapësirën online. "Dukuria më e shpeshtë gjatë publikimit të ndonjë storjeje apo teksti hulumtues, në kontekstin e kërcënimeve dhe frikësimit ndaj gazetarëve, ndodh në rrjetet sociale nga burra të panjohur, dhe komentet janë në mënyrë frikësuese nënçmuese, seksiste dhe mjaft shoviniste vetëm për faktin se autori i atij teksti apo storjeje është grua."⁶⁸

Sipas Regjistrimit të SHGM-së,⁶⁹ nga gjithsej pesë raste të regjistruara në vitin 2025, dy janë incidente në të cilat janë sulmuar gazetarë, prej të cilave njëri lidhet me djegien e një automjeti personal të një gazetareje nga Ohri⁷⁰, ndërsa tjetri lidhet me ngacmim të bazuar në gjini ndaj disa gazetarëve.⁷¹ Gazetarët shpesh përballen me fyerje dhe nënçmime kur raportojnë për tema të ndjeshme. Përdoren cilësime që u referohen vetëm grave, me kuptim pejorativ, të bazuara në paragjykime dhe stereotipe gjinore, dukuri që në mënyrë indirekte reflektohen në të ardhmen e tyre profesionale dhe në jetën e tyre private.

66 Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, „Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2022”, gusht, 2023.

67 Deklaratë e një gazetareje nga një media online, pjesëmarrëse në një grup fokusi të mbajtur më 26.12.2025.

68 Deklaratë e një gazetareje-redaktore nga një media e shkruar dhe online, për nevojat e këtij raporti, pjesëmarrëse në një grup fokusi të mbajtur më 26.12.2025.

69 Regjistri i rasteve të shkeljes së të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë ndër vite, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM).

70 Në janar të vitit 2025, në oborrin e shtëpisë familjare është djegur automjeti i gazetares Suzana Vrencovska, korrespondente nga Ohri për SDK.mk.

71 Zoran Bozhinovski përjashtohet nga SHGM për shkelje të rënda etike dhe ngacmim të bazuar në gjini, 02.10.2025.

C. SIGURIA E GAZETARËVE

— C.1 GAZETARËT DHE AKTORËT MEDIATIKË KANË QASJE NË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE MBROJTËSE KUR JANË TË EKSPOZUAR NDAJ KËRCËNIMEVE

Prokurori kompetent për rastet që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve, i emëruar nga Prokuroria Themelore Publike në vitin 2022, është një pikë kyçe kontakti për komunikim të drejtpërdrejtë me gazetarët në rastet e sulmeve fizike, kërcënimeve apo formave serioze të ngacmimit. Një linjë e tillë e hapur komunikimi paraqet një hap të rëndësishëm përpara në mbrojtjen institucionale të gazetarëve, por efektiviteti i këtij mekanizmi megjithatë varet nga shpejtësia e reagimit dhe nga rezultati i procedurës. Për këtë qëllim nevojitet një koordinim më i mirë ndërmjet Prokurorisë Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në të gjitha rastet e kërcënimeve, presioneve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Në vitin 2025, SHGM regjistroi pesë raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, që është një rritje për një rast krahasuar me vitin paraprak. Dy incidente veçohen për nga serioziteti: i pari lidhet me ngacmimin online, deklarata agresive, shqetësuese apo diskriminuese ndaj një grupi gazetareje nga gazetari dhe redaktori i portalit Bure Vesnik, Zoran Bozhinovski, ndërsa i dyti është rasti i shkatërrimit të pronës dhe ndërhyrjes në redaksinë e Infomax nga një person i panjohur. Të gjitha rastet janë raportuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pas ndërhyrjes dhe shkatërrimit të pronës së redaksisë së Infomax (i kryer nga një person i panjohur), është ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore Penale Shkup, e cila ka shqiptuar një dënim me kusht për autorin. Në lidhje me rastin e Zoran Bozhinovskit, procedura ligjore po zhvillohen para Prokurorisë Themelore Publike, Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.

— C.2 GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË MEDIATIKË (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE ËSHTË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË QASJE NË MEKANIZMA TË VEÇANTË PËR MBROJTJE/SIGURI

Korniza ekzistuese ligjore mundëson zbatimin e masave për mbrojtjen e viktimave të kërcënimeve dhe dhunës, përfshirë edhe gazetarët, por zbatimi praktik i këtyre mekanizmave është i kufizuar. Ligji për Procedurë Penale parashikon masa mbrojtëse në rastet kur siguria e gazetarit (si dhe e çdo personi tjetër) është seriozisht e rrezikuar. Sipas nenit 146, paragrafi 1, pika 6, mund të shqiptohet masa e ndalimit të afrimit ose vendosjes së kontaktit me një person të caktuar, por kjo masë mund të zbatohet vetëm nëse autori është identifikuar dhe nëse procedura tashmë është në zhvillim. Megjithatë, edhe pse synimi ligjor është të sigurojë një mekanizëm mbrojtës kundër kërcënimeve ndaj jetës dhe integritetit fizik, modeli ekzistues në praktikë nuk i mbulon të gjitha situatat me rrezik, veçanërisht në rastet kur kërcënimet vijnë nga persona të panjohur ose përmes platformave online. Në këto rrethana,

mbrojtja ligjore rezulton e pamjaftueshme për parandalim në kohë. Gjatë vitit 2025 nuk janë regjistruar raste në të cilat gazetarët kanë kërkuar formalisht mbrojtje fizike përmes mekanizmave ekzistues ligjorë, gjë që tregon një nivel të ulët besimi në efektivitetin e tyre ose mungesë të informimit për zbatimin praktik të tyre. Edhe më tej, gazetarët që përballen me kërcënime më së shpeshti i drejtohen SHGM-së, e cila më pas ndërmjetëson dhe kërkon nga institucionet kompetente të ndërmarrin masa përkatëse për mbrojtje urgjente. Në vend ekzistojnë disa organizata që ofrojnë mbështetje për viktimat e formave të ndryshme të dhunës, përfshirë ndihmë ligjore dhe psikologjike. Në vitin 2024, SHGM publikoi një Udhëzues për sigurinë e gazetarëve, në bashkëpunim me Prokurorinë Publike dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, si një mjet praktik për veprim në rastet e kërcënimeve, presioneve dhe dhunës gjatë ushtrimit të detyrave profesionale.

Në të ardhmen është e domosdoshme avancimi i protokolleve të veçanta për mbrojtjen e gazetarëve në situata me rrezik të lartë, si dhe vendosja e procedurave të qarta për reagim të shpejtë nga institucionet, me qëllim që këta mekanizma të bëhen funksionalë dhe të aksesueshëm në praktikë, e jo vetëm të parashikuar formalisht me ligj.

— C.3 GAZETARET KANË QASJE NË MASA LIGJORE DHE MEKANIZMA MBËSHTETËS KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE

Konventa e Stambollit, e ratifikuar në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018, përbën bazë për një qasje sistematike në parandalimin dhe sanksionimin e dhunës me bazë gjinore. Parimet e saj janë të integruara në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, i cili parashikon detyrime për institucionet në lidhje me parandalimin, mbrojtjen e viktimave dhe sigurimin e ndihmës juridike falas. Edhe pse korniza ligjore parashikon mekanizma mbështetës, zbatimi i tyre praktik është i pamjaftueshëm në rastet e kërcënimeve me bazë gjinore dhe sulmeve online ndaj gazetarëve. Në vitin 2025, shqetësues është rritja e rasteve të ngacmimit online, sulmeve të seksualizuara dhe deklaratave diskriminuese ndaj gazetarëve, duke krijuar një mjedis armiqësor për punën e tyre profesionale.

Institucionet kompetente për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore janë policia, qendrat për punë sociale, Avokati i Popullit, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, prokuroritë dhe gjykatat. Edhe pse ekziston një sistem i integruar për mbledhjen e të dhënave, ai ende nuk i kategorizon incidentet sipas profesionit të viktimës, për shkak të së cilës nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për numrin e gazetarëve ndër viktimat.

Gazetarët më së shpeshti i raportojnë incidentet në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose drejtpërdrejt në SHGM, e cila mban një regjistër të vetin për sulmet ndaj gazetarëve dhe gazetarëve. Shkalla reale e ngacmimit me bazë gjinore është me gjasë më e lartë se ajo e regjistruar,

pasi gazetaret shpesh nuk i raportojnë incidentet. Edhe pse ekziston mundësia për t'iu drejtuar Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vitin 2025 para këtij institucioni janë paraqitur vetëm shtatë ankesa për raste diskriminimi ndaj gazetarëve, të gjitha nga SHGM.

— C.4 ËSHTË VENDOSUR PRAKTIKA E DËNIMIT PUBLIK TË RREGULLT TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE

Në vitin 2025 u vërejt një rritje e numrit të rasteve të presioneve publike, diskreditimit dhe pengimit të punës së gazetarëve dhe profesionistëve mediatikë. Edhe pse ka reagime nga funksionarë qeveritarë për dënimin e kërcënimeve apo dhunës ndaj gazetarëve, janë regjistruar edhe shembuj të retorikës negative, fyerjeve publike dhe presioneve nga ana e politikanëve, partive politike, funksionarëve publikë dhe institucioneve të tjera.

Në shkurt të vitit 2025, shoqatat e gazetarëve dënuan ashpër fushatën e diskreditimit të drejtuar ndaj mediave të pavarura dhe kritike. Kjo fushatë, e përforcuar më tej në rrjetet sociale, kishte për qëllim të diskreditonte mediat dhe gazetarët që vazhdimisht zbulojnë korrupsionin, abuzimin me pushtetin dhe çështje të tjera me interes publik. Narrativa tendencioze se këto media kanë marrë fonde nga USAID për të minuar demokracinë paraqet një përpjekje për të delegjitimuar punën e tyre, megjithëse raportimi i tyre ka çuar në reforma ligjore, hetime penale dhe sanksione ndaj përgjegjësve për abuzime të ndryshme.⁷²

SHGM reagoi edhe ndaj etiketimit politik të gazetarëve, kur një deputet i partisë në pushtet, në dy konferenca për shtyp radhazi, përdori kualifikime të papërshtatshme për gazetarin Ordanovski, duke e vendosur atë në një kontekst politik dhe partiak. Kjo retorikë, kur vjen nga bartës të pushtetit, jo vetëm që është kundërproduktive për diskursin publik të lirë, por krijon edhe rrezik për thellimin e mosbesimit dhe nxitjen e urrejtjes ndaj gazetarëve⁷³.

Në mars të vitit 2025, shoqatat e gazetarëve reagueshan edhe ndaj fushatës së koordinuar online të ngacmimit dhe diskreditimit të drejtuar ndaj redaktorit të Infomax, Aleksandar Mitovski, pas publikimit të një videoje në rrjetet sociale nga një takim i tij me një ish-kryeministër. Materiali video u keqpërdor me qëllim krijimin e narrativave negative ndaj Mitovskit, të cilat më pas u përhapën përmes provokatorëve, por edhe përmes botëve anonimë, duke rezultuar në një fushatë masive online, gjuhë urrejtjeje dhe thirrje për dhunë.

Në maj të vitit 2025, drejtori i Agjencisë Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet, Petar Bogojeski, bëri deklaratë të papërshtatshme dhe të ashpra të drejtuara ndaj redaksisë së portalit Racin.mk, gazetarëve dhe redaktorëve të

72 [Dënim për fushatën e diskreditimit të mediave të pavarura dhe kërcënimet ndaj gazetarëve – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\)](#), 12 shkurt, 2025.

73 [SHGM: Etiketimi politik i gazetarëve është i papranueshëm – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\)](#), 22 shkurt, 2025.

saj. Veçanërisht shqetësuese është që deklarata të tilla vijnë nga funksionarë publikë, përkatësisht përfaqësues politikë, pasi ato e zhvlerësojnë reputacionin e institucionit që përfaqësojnë dhe mund të nxisin urrejtje dhe akte të motivuara nga urrejtja ndaj gazetarëve⁷⁴. Në korrik të vitit 2025, Ministria e Shëndetësisë drejtoi apele ndaj mediave, të cilat për nga përmbajtja ishin kufizuese dhe u interpretuan si presion institucional mbi mediat, si dhe përpjekje për të vendosur një praktikë të keqe institucionale në marrëdhëniet me mediat, veçanërisht kur bëhet fjalë për ngjarje të ndjeshme me interes publik⁷⁵. Në shtator të vitit 2025, një e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë u soll në mënyrë të papërshtatshme dhe joprofesionale ndaj gazetarëve gjatë një ngjarjeje publike ku ishte i pranishëm edhe ministri i Shëndetësisë, Azir Aliu⁷⁶. Edhe gjatë zgjedhjeve, gazetarët dhe punonjësit mediatikë u përballën me kufizime në qasjen dhe raportimin nga vendvotimet⁷⁷. Pas përfundimit të zgjedhjeve, në një konferencë për media, partia opozitare LSDM drejtoi deklarata diskredituese ndaj disa mediave⁷⁸.

Të gjitha këto raste tregojnë se, pavarësisht dënimit të rregullt publik të sulmeve ndaj gazetarëve, ende ekzistojnë sfida sa i përket sjelljes dhe komunikimit të funksionarëve publikë me gazetarët dhe mediat.

— C.5 AUTORITETET POLICORE JANË TË NDJESHME NDAJ ÇËSHTJES SË MBROJTJES SË GAZETARËVE

Gjatë vitit 2025, SHGM dhe Ministria e Punëve të Brendshme vazhduan dhe thelluan bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së gazetarëve, me qëllim reagimin në kohë në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë edhe në hapësirën online, ku vërehet një rritje e numrit të ngacmimeve dhe kërcënimeve ndaj punonjësve mediatikë krahasuar me vitin e kaluar. Ministria e Punëve të Brendshme e konfirmoi sigurinë e gazetarëve si një nga prioritetet kryesore dhe, në këtë drejtim, në faqen e saj zyrtare vendosi qasje në regjistrin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe intensifikoi koordinimin me SHGM-në dhe aktorë të tjerë për reagim të shpejtë ndaj rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve, përfshirë edhe përmes aktiviteteve si kampi për sigurinë e gazetarëve të rinj, të cilin SHGM dhe Misioni i OSBE-së në Shkup e organizojnë tradicionalisht për të tretin vit radhazi.

Në vitin 2025, në kuadër të Sektorit për Krim Kompjuterik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme u caktua një person si pikë kontakti përgjegjës për rastet e sulmeve dhe ngacmimeve online. Përveç kësaj, Ministria e Punëve të Brendshme caktoi edhe persona kontakti për mbrojtjen e gazetarëve në nivel lokal.

74 [SHGM: Funksionarët publikë të përmbahen nga fyerjet dhe diskreditimet ndaj gazetarëve dhe mediave – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\), 27 maj 2025.](#)

75 [SHGM: Apelet e Ministrisë së Shëndetësisë janë në kufijtë e censurës – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\), 6 korrik 2025.](#)

76 [SHGM dhe SPGPM: Sjellja e papërshtatshme e përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë ndaj gazetarëve është e papranueshme – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\), 3 shtator 2025.](#)

77 [SHGM: Të sigurohet respektimi dhe puna e papenguar e punonjësve mediatikë në vendvotime – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\), 19 tetor 2025.](#)

78 [SHGM: Subjektet politike duhet të përmbahen nga etiketimi dhe diskreditimi publik i mediave – Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\), 13 dhjetor 2025.](#)

Megjithatë, përkundër këtij progresi të arritur në vitin 2025, është e nevojshme të përmirësohet më tej qasja e policisë ndaj gazetarëve, veçanërisht gjatë raportimit nga terreni, ku gazetarët dhe punonjësit mediatikë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të shtuara. Nevojitet forcim i vazhdueshëm i kapaciteteve të punonjësve policorë në lidhje me lirinë e mediave dhe rëndësinë e sigurisë së gazetarëve.

— C.6 NJËSITË E SPECIALIZUARA HETIMORE DHE/ OSE ZYRTARËT KANË EKSPERTIZËN E DUHUR PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE

Njësitë e specializuara hetimore dhe/ose zyrtarët në mënyrë formale disponojnë një nivel të caktuar ekspertize për trajtimin e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, ndërsa gjatë vitit 2025 u afirmuan më tej edhe pikat ekzistuese të kontaktit në prokurori dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe protokollet policore për reagim urgjent.

Megjithatë, pavarësisht komunikimit të dukshëm dhe takimeve të rregullta ndërmjet SHGM-së, prokurorisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, bashkëpunimi ende nuk rezulton me përpunim mjaftueshëm efikas të rasteve, veçanërisht kur bëhet fjalë për kërcënime online dhe dhunë digjitale. Deklaratat e përfaqësuesve të institucioneve për protokolle të përmirësuara dhe koordinim më të mirë tregojnë për përparim formal, por zbatimi praktik mbetet i pabarabartë dhe i ngadalshëm.

Sipas të dhënave nga Regjistri i SHGM-së, deri në fund të vitit 2025 janë evidentuar gjithsej 85 sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve në periudhën 2014–2025, ndërsa vetëm një numër i kufizuar rastesh kanë përfunduar me vendim gjyqësor. Ky disbalancë ndërmjet angazhimeve normative dhe rezultateve reale tregon se, pavarësisht komunikimit ekzistues, nevojitet thellim i bashkëpunimit institucional, forcim i kapaciteteve hetimore dhe të prokurorisë, si dhe një politikë më vendimtare ndëshkuese për të siguruar mbrojtje më efektive të gazetarëve.

— C.7 HETIMET PËR SULME SERIOZE FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIKË KRYHEN NË MËNYRË EFIKASE (TË PAVARUR, TË THELLUARA DHE NË KOHË)

Gjatë vitit 2025, SHGM në regjistrin e saj evidentoi pesë sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, që paraqet rritje të numrit të incidenteve krahasuar me vitin paraprak. Të gjitha rastet u raportuan në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa një pjesë edhe në Prokurorinë Themelore Publike.

Veçanërisht shqetësues është trendi i sulmeve dhe kërcënimeve online, ku në vitin 2025 vërehet rritje e këtyre incidenteve (5 në vitin 2025, 4 në vitin 2024), më së shpeshti të drejtuara ndaj gazetarëve. Sipas informacioneve me të cilat disponon SHGM, për dy nga rastet e raportuara në vitin 2025 tashmë janë ndërmarrë veprime konkrete, përfshirë ndalimin e personave të dyshuar dhe marrjen e vendimeve

gjqësore. Megjithatë, tre nga rastet e tjera të regjistruara janë ende në fazë parahetimore ose hetimore, ose rezultati i procedurave nuk është përfundimtar, ndërsa disa prej tyre mbeten pa zgjidhje. Kjo tregon nevojën për më shumë transparencë dhe një reagim institucional më efikas në trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.

Për krahasim, në vitin 2022 janë evidentuar 7 sulme, nga të cilat 2 raste përfunduan me vendim gjyqësor. Në vitin 2023 numri i sulmeve u ul në 5, ku gjithashtu 2 raste morën epilog gjyqësor, ndërsa në vitin 2024 u regjistruan 4 sulme dhe për 3 prej tyre u iniciua procedurë.

Megjithatë, fakti që një pjesë e rasteve nga vitet e kaluara mbeten të pazgjidhura konfirmon se problemi i mosndëshkimit vazhdon të jetë i pranishëm. Edhe pse nga pesë rastet e regjistruara në vitin 2025 për dy tashmë është marrë vendim gjyqësor, trajtimi i ngadalshëm dhe i paplotë i tre rasteve të tjera e dëmton besimin e komunitetit gazetaresk ndaj institucioneve dhe e thellon ndjenjën e pasigurisë.

— C.8 GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË MEDIATIKË MBROHEN NË MËNYRË EFIKASE NGA FORMA TË NDRYSHME TË NGACMIMEVE NË INTERNET

SHGM vlerëson se ndryshimet në Kodin Penal, të miratuara në vitin 2023, përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes ligjore të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Me këto ndryshime, veprat penale vrasje (neni 123), detyrim (neni 139), rrezikim i sigurisë (neni 144) dhe pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare (neni 382) kualifikohen më rëndë kur kryhen ndaj gazetarëve, duke paraparë sanksione më të rrepta dhe veprim të detyrueshëm sipas detyrës zyrtare nga ana e prokurorisë.

Përveç kësaj, me ndryshimet ligjore u fut edhe vepra penale "përndjekje" (neni 144-a), e cila përfshin ndjekje apo ngacmim të vazhdueshëm dhe të padëshiruar që tek viktima krijon ndjenjë frike dhe pasigurie. Sipas vlerësimit të ekspertëve juridikë, kjo normë është veçanërisht relevante për gazetarët, të cilët në vitin 2025 gjithnjë e më shpesh janë të ekspozuar ndaj formave të tilla të presionit, sidomos përmes platformave online.

Megjithëse ishte paralajmëruar se gjatë vitit 2025 do të ndërmerreshin ndryshime të mëtejshme dhe miratimi i një Kodi të ri Penal, kjo nuk u realizua brenda afatit të paraparë⁷⁹. Siç është njoftuar⁸⁰ nga Ministria e Drejtësisë, versioni draft i Kodit të ri Penal është përgatitur, por miratimi i tij është shtyrë për shkak të nevojës për harmonizim të mëtejshëm me disa direktiva të Bashkimit Evropian⁸¹. Në kuadër të tekstit të ri ligjor parashihet edhe futja e një vepre të re penale që lidhet me keqpërdorimin e incizimeve, fotografive dhe materialeve

79 Samarxhiskij, A. [Deputetët me ndryshime të shkurtra i ashpërsojnë dënimet për keqpërdorime, ligji i ri do të presë](#), Radio Evropa e Lirë, dhjetor 2025.

80 [Njoftim për përgatitjen e hartimit të një propozim-ligji të ri](#), Ministria e Drejtësisë, 2025.

81 Bëhet fjalë për Direktivën për mbrojtjen e mjedisit përmes të drejtës penale (EcoCrime), Direktivën për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, Direktivën për rikthimin e pasurisë dhe konfiskimin, si dhe Propozim-direktivën për luftën kundër korrupsionit.

audio-vizuale me përmbajtje seksualisht eksplicite, përfshirë edhe përmbajtje manipuluese të krijuara me inteligjencë artificiale (deepfake), gjë që ka rëndësi edhe për mbrojtjen e gazetarëve nga forma të reja të abuzimit digjital.

— C.9 HETIMET PËR TË GJITHA LLOJET E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIKË KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Pavarësisht bashkëpunimit të vendosur të SHGM-së me institucionet kompetente, gjendja në vitin 2025 tregon për një nevojë të vazhdueshme për transparencë më të madhe dhe reagim më efikas institucional. Informimi i pamjaftueshëm dhe i parregullt për rrjedhën e procedurave kontribuon në perceptimin e mosndëshkimit dhe ul besimin e komunitetit gazetaresk në sistemin e mbrojtjes.

Gjatë vitit 2025, transparenca e procedurave gjyqësore në të cilat janë të përfshirë gazetarë mbeti në një nivel të përafërt me vitet e mëparshme. Gjykatat themelore civile dhe penale në Shkup ende nuk ofrojnë në mënyrë proaktive informacione të detajuara për lëndët që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve, përveç në rastet kur paraqiten kërkesa individuale. Po ashtu, nuk është vendosur një praktikë e informimit të rregullt të publikut apo të organizatave të gazetarëve, përfshirë SHGM dhe SPGPM, për ecurinë e këtyre procedurave.

SHGM edhe gjatë vitit 2025 i ndoqi rastet e regjistruara përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me organet gjyqësore dhe të prokurorisë. Sipas të dhënave të marra nga Prokuroria Themelore Publike Shkup, për dy raste nga Regjistri i SHGM-së janë duke u zhvilluar procedura. Në rastin që lidhet me djegien e automjetit të gazetares Vrencovska, procedura ende ndodhet në fazën e parahetimit, ndërsa janë dhënë udhëzime për Ministrinë e Punëve të Brendshme që janë në zbatim. Ndërkohë, në rastin e sulmit fizik ndaj një ekipi gazetaresk të Alsat M gjatë raportimit për një zjarr të madh, është dhënë një vendim dënues bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e autorit.

— C.10 SISTEMET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE STATISTIKORE CILËSORE JANË VENDOSUR NGA ORGANET SHTETËRORE PËR TË PARANDALUAR MOSNDËSHKIMIN

Gjatë vitit 2025, Ministria e Punëve të Brendshme nuk kishte vendosur dhe publikuar një regjistër publik të rasteve të shkeljes së të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Është vërejtur një përparim i vogël, por i rëndësishëm në aspektin e ndjekjes statistikore të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Ministria e Punëve të Brendshme në faqen e saj zyrtare publikoi një link të veçantë⁸² për ndjekjen e këtyre incidenteve, i cili çon drejtpërdrejt në faqen zyrtare të SHGM-së dhe në Regjistrin publik të sulmeve që e mban SHGM.

82 [Ministria e Punëve të Brendshme publikoi regjistrin e sulmeve ndaj gazetarëve](#), 360 Gradë, 02.10.2025.

Në gjyqësor, gjendja edhe në vitin 2025 mbetet e pandryshuar. Institucionet gjyqësore ende nuk disponojnë sisteme funksionale statistikore që mundësojnë evidentimin dhe kërkimin e lëndëve sipas profesionit të palëve. Bazat ekzistuese të të dhënave nuk mundësojnë veçimin e rasteve në të cilat janë të përfshirë gazetarë ose media, gjë që e vështirëson ndjekjen sistematike të procedurave dhe shpesh përmendet si arsye për mungesën e një regjistri të veçantë për shkeljet e të drejtave të punonjësve mediatikë. Për shkak të këtyre kufizimeve, SHGM vazhdon t'i sigurojë informacionet e nevojshme për lëndët gjyqësore kryesisht përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë.

Pavarësisht hapave pozitivë të paralajmëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, gjendja aktuale tregon se është i domosdoshëm përmirësimi i mëtejshëm i sistemeve statistikore si në pushtetin ekzekutiv ashtu edhe në atë gjyqësor, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë dhe uljen e rrezikut nga mosndëshkimi i sulmeve ndaj tyre.

— C.11 KËRCËNIME DHE NGACMIME QË NUK LIDHEN ME SIGURINË FIZIKE

Gjatë vitit 2025, ish-redaktori i një televizioni kombëtar, Dragan Pavloviq Latas, i afërt me partinë aktuale në pushtet VMRO-DPMNE, në rrjetin social Facebook targetoi gazetarë nga disa media, duke keqpërdorur fotografi private nga profilet e tyre dhe duke i përdorur ato në publikimet e tij⁸³. Në publikimet e tij, ai shpërndau akuza të pabazuara dhe teori konspirative, që synojnë diskreditimin e gazetarëve dhe mediave që informojnë në mënyrë profesionale për çështje relevante shoqërore. Kjo praktikë e targetimit dhe stigmatizimit publik të gazetarëve, përfshirë edhe gazetarë që kanë marrë vlerësime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për punën e tyre, përbën një sulm serioz ndaj lirisë së shprehjes dhe gazetarisë së pavarur.

Bordi Drejtues i SHGM-së, duke vepruar sipas propozimit të Këshillit të Nderit pranë SHGM-së, në tetor të vitit 2025 mori vendim për përjashtimin e Zoran Bozhinovskit nga anëtarësia në SHGM për shkak të shkeljeve të disa neneve të Kodit Etik të Gazetarëve. Vendimi u mor për shkak të shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të Kodit Etik, të kryera përmes një serie publikimesh që nxisin ngacmim me bazë gjinore ndaj gazetarëve dhe cenojnë privatësinë dhe reputacionin e tyre. Përveç kësaj, këto publikime nxitën komente keqdashëse që inkurajojnë persona të tjerë të përhapin gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime, duke krijuar kështu një mjedis armiqësor dhe duke rritur rrezikun për sigurinë e gazetarëve.

83 [SHGM dhe SPGPM: Dënim për targetimin keqdashës të gazetarëve dhe mediave nga Dragan Pavloviq Latas](#), 26.02.2025.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Kërcënime dhe ngacmime që nuk lidhen me sigurinë fizike të gazetarëve Kjo kategori kërcënimesh dhe ngacmimesh përfshin: mbikëqyrje ose ndjekje; – thirrje telefonike ngacmuese; – ngacmime arbitrare gjyqësore ose administrative; – deklarata agresive nga zyrtarë publikë; – forma të tjera presioni që mund të rrezikojnë sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së punës së tyre. Këto lloje kërcënimesh nuk përfshijnë mobing dhe dhunë në ambientin e punës.	2	– Deklarata ngacmuese ose diskriminuese, kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve nga një ish-gazetar dhe redaktor televizioni ndaj kolegëve gazetarë. – Zoran Bozhinovski, përmes një serie publikimesh, nxiste ngacmim me bazë gjinore ndaj gazetarëve dhe cenonte reputacionin e tyre dhe të drejtën për privatësi.

— C.12 KËRCËNIME NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Në vitin 2025, SHGM nuk ka regjistruar kërcënime të këtij lloji ndaj jetës së gazetarëve.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Kërcënime për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve Ky lloj kërcënimesh përfshin: – kërcënime për vrasje ndaj gazetarëve, miqve të tyre, anëtarëve të familjes së tyre ose burimeve të informacionit; – kërcënime për lëndime fizike ndaj gazetarëve, miqve të tyre, anëtarëve të familjes së tyre ose burimeve të informacionit. Këto kërcënime mund të jenë: – të drejtpërdrejta ose përmes personave të tretë; – të dërguara nëpërmjet mjeteve elektronike ose në mënyrë direkte ballë për ballë; – të nënkuptuara, por edhe të shprehura qartë	0	– Në vitin 2025 nuk është evidentuar asnjë rast që bën pjesë në këtë kategori.

— C.13 SULME REALE

Në fillim të vitit u raportua një incident në të cilin u dogj automjeti i gazetares Suzana Vrencovska, korrespondente e portalit online SDK.mk nga Ohri. Automjeti u dogj në oborrin e shtëpisë familjare, në garazhin ku ishte i parkuar.

Gjatë vitit të kaluar, sipas regjistrimit zyrtar të sulmeve dhe kërcënimeve të SHGM-së⁸⁴, është regjistruar një shkelje e rëndë e të drejtave të gazetarit Avni Tahiri dhe kameramanit Shenol Hajredini. Sipas informacioneve nga gazetari dhe kameramani, ata janë sulmuar fizikisht gjatë raportimit për zjarrin e madh në deponinë ilegale në Vizbegovë, nga pronari i mbeturinave për të cilin dyshohet se e ka shkaktuar zjarrin. Sulmuesi ia mori me forcë telefonin mobil gazetarit Tahiri dhe e hodhi në zjarr, ndërsa kameramani Shenol Hajredini u sulmua gjithashtu dhe iu thye kamera. Rasti është raportuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pas së cilës autori është arrestuar.

84 [Regjistri](#) i sulmeve dhe kërcënimeve i SHGM-së.

Në dhjetor të vitit 2025, në SHGM u raportua një sulm brutal në redaksinë e "Infomax" gjatë transmetimit të një programi live, nga një person i panjohur, duke rrezikuar sigurinë e gazetarëve Aleksandar Mitovski dhe Milosh Miloshevski, si dhe të punonjësve të redaksisë. Sipas informacioneve nga kolegët, një person i panjohur mbërriti me taksi para redaksisë gjatë emisionit. Sulmuesi filloi të godiste dhe të trokiste në mënyrë agresive në derën hyrëse, e cila ishte e mbyllur dhe e siguruar me kod. Pas një kohe të shkurtër, ai arriti ta thyejë me forcë dhe të hyjë në oborrin e redaksisë. Në momentin kur ekipi bëri një pauzë nga transmetimi, gazetari Miloshevski doli për të parë çfarë po ndodhte. Sulmuesi vazhdoi të lëvizte drejt pjesës tjetër të objektit, ku me forcë theu edhe një derë tjetër duke u përpjekur të arrinte në studio. Personi drejtonte fyerje dhe kërcënime për jetë, ndërsa ndërhyrja e dhunshme në redaksi çoi edhe në ndërprerjen me forcë të transmetimit të programit, duke penguar drejtpërdrejt gazetarët në ushtrimin e detyrës së tyre profesionale dhe në informimin e lirë.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Sulme të vërteta Llojet e sulmeve reale ndaj gazetarëve mund të përfshijnë lëndime fizike ose psikike, rrëmbim, hyrje në banesë ose zyrë, konfiskim të pajisjeve, ndalim arbitrar, tentativë të pasuksesshme për atentat etj.	3	<ul style="list-style-type: none"> Në janar të vitit 2025 u dogj automjeti i gazetares nga Ohri, Suzana Vrencovska, në oborrin e shtëpisë familjare. Në korrik të vitit 2025 ndodhi një sulm fizik ndaj ekipit gazetaresk të televizionit ALSAT M, i cili po raportonte për një zjarr të madh në Shkup. Në dhjetor të vitit 2025 ndodhi një ndërhyrje e dhunshme në redaksinë e Infomax, që çoi edhe në ndërprerjen me forcë të transmetimit të programit, duke penguar drejtpërdrejt gazetarët të kryenin detyrën e tyre profesionale dhe të informonin lirshëm.

— C.14 KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

SHGM, në vitin 2025 nuk regjistroi sulme të këtij lloji. Krahasuar me vitet e kaluara në këtë dimension, për këtë tregues, situata mbetet e pandryshuar.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe organizatave të gazetarëve Sulme reale ndaj pronës së mediave dhe organizatave, stafit të tyre, konfiskim i pajisjeve, deklarata agresive nga zyrtarë publikë etj. Gjithashtu, kërcënimet dhe sulmet mund të përfshijnë disa nga kategoritë e përmendura më sipër.	0	<ul style="list-style-type: none"> Në vitin 2025 nuk është regjistruar asnjë rast që i përket kësaj kategorie.



Përfundime dhe rekomandime

PËRFUNDIME

GARANCITË LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

Në vitin 2025, korniza ligjore për mediat dhe sigurinë e gazetarëve formalisht shënon disa përmirësime, por zbatimi praktik mbetet i paqëndrueshëm dhe selektiv. Ndryshimet në legjislacionin penal dhe në përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje nga vitet e kaluara krijuan garanci më të forta ligjore, por praktika gjyqësore ende nuk siguron mbrojtje mjaftueshëm të shpejtë dhe efektive për gazetarët.

Në prill të vitit 2025, u vendos regjistri i mediave online në kuadër të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me ç'rast për herë të parë portalet e internetit u përcaktuan si media me të drejta dhe obligime të qarta. Ky hap kontribuon në rritjen e transparencës dhe profesionalizimit, por njëkohësisht mbetet e hapur çështja e anashkalimit të këtij regjistri në reklamimin politik të paguar, gjë që krijon hapësirë për keqpërdorime dhe financim jotransparent të sferës mediatike.

Pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme nga institucionet evropiane, shteti ende nuk ka vendosur mekanizma sistematikë për mbështetjen e pluralizmit mediatik dhe gazetarisë me interes publik. Rikthimi i fushatave të financuara nga shteti në mediat private e rrit rrezikun e ndikimit politik në politikat redaktuese, si dhe varësinë ekonomike të redaksive. Nevoja për një Ligj të ri gjithëpërfshirës për media, me fokus të fortë në mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në redaksi, mbetet prioritet.

Për më tepër, mungesa e mekanizmave efektivë kundër SLAPP-it rrit cenueshmërinë e gazetarëve ndaj padive strategjike që synojnë të heshtin raportimin kritik. Edhe pse ekzistojnë standarde dhe rekomandime ndërkombëtare, zbatimi i tyre në legjislacionin kombëtar ende nuk është i plotë.

POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSI

Në vitin 2025, gjendja socio-ekonomike e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë mbetet seriozisht shqetësuese. Pjesa më e madhe e gazetarëve marrin paga nën mesataren shtetërore, ndërsa situata është edhe më e pafavorshme për punonjësit mediatikë në mediat private dhe në redaksitë lokale. Edhe pse gjendja në servis publik është relativisht më e mirë, mungesa e kuadrit, veçanërisht e profesionistëve të rinj dhe stafit të specializuar, e minon qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit.

Presionet komerciale dhe ndikimi politik vazhdojnë të kufizojnë autonominë redaktuese në një pjesë të mediave, duke rezultuar në vetëcensurë dhe kufizim të hapësirës për gazetari hulumtuese. Mbrojtja e pamjaftueshme e të drejtave të punës, kontratat e pasigurta dhe kushtet e paqëndrueshme të punës ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e punës gazetareske dhe rrisin cenueshmërinë e gazetarëve ndaj presioneve të jashtme.

SIGURIA E GAZETARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në vitin 2025 vërehet një ulje relative e sulmeve fizike ndaj gazetarëve, por kërcënimet online, gjuha e urrejtjes dhe etiketimi publik i gazetarëve nga aktorë politikë dhe bartës të funksioneve publike mbeten problem serioz. Rrjetet sociale vazhdojnë të jenë kanali kryesor për frikësim dhe diskreditim, veçanërisht ndaj gazetarëve që raportojnë për korrupsion, abuzime dhe çështje me interes publik.

Edhe pse është forcuar bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorinë Themelore Publike përmes vendosjes së pikave të kontaktit për rastet që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve, niveli i lartë i mosndëshkimit mbetet problem kyç. Procedurat hetimore janë të ngadalta, ndërsa zgjidhjet gjyqësore janë të rralla, gjë që nxit kulturën e mosndëshkimit dhe inkurajon autorët e mundshëm.

Përveç kësaj, numri i padive SLAPP shënon rritje gjatë viteve të fundit, gjë që krijon "efekt ftohës" mbi gazetarinë kritike dhe hulumtuese.

REKOMANDIME

A: GARANCITË LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

- Miratimi urgjent i një Ligji të ri për media me fokus të qartë në mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në redaksi.
- Vendosja e një Fondi për pluralizëm dhe gazetari me interes publik, me kritere të qarta dhe transparente për shpërndarjen e mjeteve, menaxhim të pavarur dhe llogaridhënie publike.
- Heqja e reklamimit politik të paguar dhe e fushatave të financuara nga shteti në mediat private dhe ridrejtimi i mjeteve drejt Fondit për pluralizëm.

- Miratimi i mekanizmave kundër SLAPP-it në legjislacionin kombëtar, në përputhje me standardet evropiane, për refuzimin e hershëm të padive abuzive kundër gazetarëve, përmes formimit të një grupi pune ndërsektorial në kuadër të Qeverisë së RMV-së.
- Zbatimi i një procedure transparente dhe gjithëpërfshirëse për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të ASHMAAV dhe Këshillit Programor të RTM-së, me dëgjime publike dhe forcim të parimit të meritës.
- Miratimi i një Ligji të ri për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, me afate dhe sanksione që sigurojnë përgjigje në kohë dhe të plota nga institucionet.
- Përmirësimi i të drejtës së autorit me mbrojtje të qartë të përmbajtjeve gazetareske si pronë intelektuale.

B: POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSI

- Intensifikimi i përpjekjeve për lidhjen e kontratave kolektive në mediat private.
- Sigurimi i pagave të drejta, kushteve dinjitoze të punës dhe kontratave të qarta të punës për gazetarët dhe punonjësit mediatikë, veçanërisht në nivel lokal.
- Zhvillimi i programeve për rikualifikim dhe trajnim shtesë, me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale dhe konkurrueshmërisë së gazetarëve.
- Trajnime të vazhdueshme për të drejtat e punës dhe pavarësinë redaktuese në redaksi.
- Mbështetje për tërheqjen dhe mbajtjen e gazetarëve të rinj përmes bursave, programeve të praktikës dhe mentorimit.

C: FORCIMI I SIGURISË SË GAZETARËVE

- Vendosja e regjistrave të veçantë për rastet e sulmeve dhe padive SLAPP kundër gazetarëve në gjykata dhe prokurori.
- Përsheptimi dhe trajtimi me prioritet i të gjitha rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve.
- Trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë, prokurorë, polici dhe avokatë për zbatimin e standardeve evropiane për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e gazetarëve.
- Përmirësimi i protokolleve institucionale për parandalim dhe reagim të shpejtë në rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.
- Thëllimi i bashkëpunimit të SHGM-së me Avokatin e Popullit dhe institucionet relevante për mbrojtjen sistematike të të drejtave të gazetarëve.
- Formimi i Komitetit Kombëtar për Mbrojtjen e Gazetarëve.


IV

Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – 2025

Kjo pjesë e raportit paraqet në formë grafike Indeks të Sigurisë së Gazetarëve për vitin 2024, duke e krahasuar atë me vitin paraprak 2023. Për secilën nga katër dimensionet dhe për të gjithë 19 treguesit, është dhënë një shpjegim i shkurtër mbi ndryshimet kyçe që kanë ndodhur gjatë vitit 2024.


Një shpjegim më i detajuar i të dhënave dhe i ndryshimeve për secilin tregues të Indeksit mund të lexohen në pjesën narrative të raportit:

Treguesit e Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve	Raport narrativ
I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	
Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediave	A.6
Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	A.8
Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	A.7
Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre	A.9
Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	B.1
II. Parandalimi	
Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve	C.1
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri	C.2
Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore	C.3
Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	C.4
Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve	C.5
III. Procesi	
Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	C.6
Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)	C.7
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacimit në internet	C.8
Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente	C.9
Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit	C.10
IV. Siguria reale	
Kërcënimet dhe ngacimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike	C.11
Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve	C.12
Sulmet e realja	C.13
Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë	C.14



	2024	2025		Ndryshimet e reja kryesore për secilin dimension
Mjedisi ligjor dhe organizativ	4.21	4.13	↓	Vërehet njëfarë regresi në mjedisin ligjor dhe organizativ, i cili kryesisht i atribuohet presionit që gazetarët ndiejnë nga paditë e reja për shpifje dhe fyerje (gjithsej 15 në vitin 2025), rezistencave ende të pranishme dhe presioneve të buta ndaj organizimit sindikal, si dhe gjendjes jashtëzakonisht të dobët socio-ekonomike të gazetarëve që punojnë në mediat private, veçanërisht në mediat online në nivel lokal.
Parandalimi	3.84	3.78	↓	Në vitin 2025 u vërejt një regres i lehtë në sigurimin e një reagimi institucional më të shpejtë dhe më efikas në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. U shënua rritje e ngacmimeve online, sulmeve seksiste dhe deklaratave diskriminuese ndaj gazetarëve. U regjistruan gjithashtu më shumë shembuj të retorikës negative, fyerjeve publike dhe diskreditimit të gazetarëve dhe mediave nga politikanë, parti politike dhe bartës të funksioneve publike.
Procesi	3.34	3.38	↑	Në vitin 2025 pati koordinim të mirë ndërmjet institucioneve kompetente, që rezultoi me efikasitet të përmirësuar në zbulimin dhe sanksionimin e sulmeve serioze ndaj gazetarëve. Nga dy rastet e sulmeve fizike në vitin 2025, të dy përfunduan me vendime gjyqësore dënuese. Është përmirësuar edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme në aspektin e ndjekjes statistikore të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.
Siguria reale	3.96	4.05	↑	Numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve është rritur krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, niveli i mosndëshkimit për këtë lloj sulmesh mbetet ende i lartë, pasi një numër i konsiderueshëm rastesh nga vitet e kaluara ende nuk janë hetuar dhe përfunduar. Shqetësues mbetet trendi i rritjes së kërcënimeve dhe sulmeve online ndaj gazetarëve në vend.
Indeksi i sigurisë së gazetarëve	3.85	3.89	↑	

Mjedisi ligjor dhe organizativ



TREGUESI 1.1

— DISPOZITAT LIGJORE QË LIDHEN ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI I TYRE NUK KRIJOJNË EFEKTE FRIKËSUERE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE

**Rezultati për vitin 2024: 4.40 /
Rezultati për vitin 2025: 4.03**

Në vitin 2025 vërehet një përkeqësim i lehtë i gjendjes për shkak se numri i padive të reja të paraqitura për shpifje dhe fyerje kundër gazetarëve dhe/ose mediave u rrit me një rast: në vitin 2025 janë paraqitur 16, ndërsa në vitin 2024 ishin 15 padi.

Në përgjithësi, Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje nuk krijon efekt frikësues ndaj gazetarëve, pasi në nëntor të vitit 2022 u ulën shumat për dëmin jomaterial që mund të caktojë gjykata. Ligji garanton lirinë e shprehjes, ndërsa kufizimet janë në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas të dhënave nga Gjykata Themelore Civile Shkup, deri në fund të vitit 2025 numri i rasteve aktive ishte 40.

TREGUESI 1.2

— KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

**Rezultati për vitin 2024: 4.89 /
Rezultati për vitin 2025: 4.89**

Gjatë vitit 2025, SHGM nuk ka vërejtur asnjë rast presioni ndaj ndonjë gazetari për të zbuluar burimin e tij konfidencial, ndërsa gazetarët që punojnë në storje hulumtuese ndiheshin të lirë në kontaktimin me burimet. Mbrojtja e burimeve gazetareske është e garantuar në Kushtetutën e RMV-së dhe e rregulluar në detaje në disa ligje. Burimet e gazetarëve inkurajohen dhe mbrohen mirë përmes Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, por për shkak të presioneve dhe frikës për vendin e punës, numri i individëve që raportojnë raste korrupsioni tek organet kompetente dhe tek gazetarët mbetet ende i ulët.

TREGUESI 1.3

— LIGJET E TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE U MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIKË TË PUNOJNË LIRSHËM DHE NË MËNYRË TË SIGURT

Rezultati për vitin 2024: 4.08 / Rezultati për vitin 2025: 4.13

Krahasuar me vitin 2024, në vitin 2025 nuk u vërejt rritje e presionit ndaj gazetarëve hulumtues nga aktorë me fuqi ekonomike apo politike, dhe nuk pati raste të zbatimit arbitrar ose diskriminues të ligjeve të tjera me qëllim kufizimin e lirisë së punës gazetareske. U regjistrua vetëm një rast i ri i një padie SLAPP ndaj një mediaje hulumtuese. Në përmirësimin e gjendjes kontribuon edhe fakti që në vitin 2025, me iniciativë

të SHGM-së, Qeveria paralajmëroi formimin e një grupi pune për vendosjen e një mekanizmi për mbrojtje nga përdorimi i padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).

TREGUESI 1.4

— GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË THEMELUJNË, TË BASHKOHEN DHE TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Rezultati për vitin 2024: 4.38 / Rezultati për vitin 2025: 4.31

Shoqatat e gazetarëve (SHGM, KEMM dhe SPGPM) nuk u përballën me presione apo sulme politike në vitin 2025, megjithëse strukturat drejtuese të disa mediave më të mëdha ushtrojnë presione të buta ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, duke penguar organizimin sindikal. Trupi vetërregullues mbetet ende i brishtë për sa i përket kapaciteteve dhe mbështetjes, gjë që pamundëson zhvillimin e aktiviteteve zhvillimore dhe hulumtuese si dhe forcimin e organizatës. SPGPM gjithashtu përballlet me mungesë burimesh dhe probleme të qëndrueshmërisë, ndërsa anëtarët e saj përballen edhe me presione nga dy sindikata paralele, në servis publik dhe në agjencinë shtetërore të lajmeve.

TREGUESI 1.5

— POZITA E PUNËS SË GAZETARËVE ËSHTË STABILE DHE E MBROJTUR NË VENDIN E PUNËS

**Rezultati për vitin 2024: 3.29 /
Rezultati për vitin 2025: 3.29**

Nuk ka përmirësim sa i përket statusit të punës dhe mbrojtjes së të drejtave të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Edhe pse në servis publik dhe në disa media më të mëdha private gazetarët dhe punonjësit mediatikë kanë kontrata pune dhe një status formal të qëndrueshëm, prekariati vazhdon të dominojë në profesionin e gazetarisë: nuk respektohet numri i përcaktuar ligjor i orëve të punës dhe nuk ka orar të përcaktuar pune, kështu që mbingarkesa me punë shndërrohet në burim të drejtpërdrejtë të stresit kronik; shumica e gazetarëve të punësuar në të gjithë sektorin kanë paga nën nivelin e pagës mesatare në shtet; një numër i madh gazetarësh në sektorin online dhe në mediat lokale kanë status të pasigurt pune dhe të ardhura jashtëzakonisht të ulëta; gazetarët – korrespondentë nga vendet më të vogla më së shpeshti angazhohen me kontrata honorare.



Parandalimi



TREGUESI 2.1

— GAZETARËT DHE AKTORËT MEDIATIKË KANË QASJE NË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE MBROJTËSE KUR JANË TË EKSPOZUAR NDAJ KËRCËNIMEVE

Rezultati për vitin 2024: 3.81 / Rezultati për vitin 2025: 3.81

Gjendja në lidhje me këtë tregues nuk ka ndryshuar. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk ekziston një mekanizëm i veçantë për raportim dhe reagim të shpejtë dhe efikas ndaj sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, por është pozitive që në Prokurorinë Themelore Publike, në vitin 2024, u caktua një prokuror kompetent me të cilin gazetarët mund të komunikojnë drejtpërdrejt në rast të sulmeve fizike, kërcënimeve apo formave serioze të ngacmimit, përfshirë edhe përmes rrjeteve sociale.

Linja e drejtpërdrejtë e komunikimit me prokurorinë përbën një hap të rëndësishëm përpara në mbrojtjen institucionale të gazetarëve, por SHGM vlerëson se reagimi duhet të jetë më i shpejtë dhe më efikas në të gjitha rastet e raportuara.

TREGUESI 2.2

— GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË MEDIATIKË (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE ËSHTË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË QASJE NË MEKANIZMA TË VEÇANTË PËR MBROJTJE/SIGURI

Rezultati për vitin 2024: 3.75 / Rezultati për vitin 2025: 3.75

Nuk ka ndryshim në vlerësimin për këtë tregues në vitin 2025. Korniza ekzistuese ligjore mundëson zbatimin e masave të veçanta për mbrojtjen e të gjithë qytetarëve, siguria fizike e të cilëve është në rrezik real, përfshirë edhe gazetarët. Megjithatë, zbatimi praktik i këtyre masave është i kufizuar, pasi ato mund të aplikohen vetëm nëse autori është identifikuar dhe nëse procedura tashmë është në zhvillim.

Gjatë vitit 2025 nuk janë regjistruar raste në të cilat gazetarët kanë pasur nevojë reale apo kanë kërkuar formalisht masa të veçanta për mbrojtje fizike.

TREGUESI 2.3

— GAZETARËT KANË QASJE NË MASA LIGJORE DHE MEKANIZMA MBËSHTETËS KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE

**Rezultati për vitin 2024: 3.58 /
Rezultati për vitin 2025: 3.50**

Në vitin 2025 vërehet një përkeqësim i caktuar për këtë tregues, për shkak të rritjes së ngacmimeve online, sulmeve seksiste dhe deklaratave diskriminuese ndaj gazetarëve. Korniza ligjore parashikon mekanizma për mbrojtjen dhe mbështetjen e gazetarëve në rastet e kërcënimeve me bazë gjinore dhe sulmeve online, por zbatimi i tyre praktik mbetet i pamjaftueshëm. Edhe pse institucionet kanë vendosur një

sistem të integruar për mbledhjen e të dhënave për këto sulme, ai nuk i kategorizon incidentet sipas profesionit të viktimës, për shkak të së cilës nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për numrin e gazetarëve ndër viktimat që janë objekt i sulmeve.

TREGUESI 2.4

— **ËSHTË VENDOSUR PRAKTIKA E DËNIMIT PUBLIK TË RREGULLT TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE**

Rezultati për vitin 2024: 3.33 / Rezultati për vitin 2025: 3.11

Në vitin 2025 vërehet përkeqësim në raportin e përfaqësuesve të pushtetit ndaj gazetarëve dhe profesionistëve mediatikë. Edhe pse herë pas here pati reagime nga funksionarë qeveritarë me dënim të kërcënimeve apo dhunës ndaj gazetarëve, megjithatë u regjistruan më shumë shembuj të retorikës negative, fyerjeve publike dhe diskreditimit të gazetarëve dhe mediave nga politikanë, parti politike dhe bartës të funksioneve publike (një deputet i partisë në pushtet në dy konferenca për shtyp bëri diskualifikime ndaj gazetarit Ordanovski; drejtori i një agjencie shtetërore përmes rrjeteve sociale sulmoi redaksinë e portalit Racin; fushatë e koordinuar online për diskreditimin e redaktorit të Infomax, etj.).

TREGUESI 2.5


— **AUTORITETET POLICORE JANË TË NDJESHME NË LIDHJE ME MBROJTJEN E GAZETARËVE**

Rezultati për vitin 2024: 4.75 / Rezultati për vitin 2025: 4.75

Nuk ka ndryshime sa i përket sjelljes së autoriteteve policore ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve. Gjatë vitit 2025 nuk janë vërejtur raste të sjelljes së ashpër të policisë ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatikë. Për Ministrinë e Punëve të Brendshme, siguria e gazetarëve është çështje prioritare; është vendosur bashkëpunim dhe koordinim i mirë me SHGM-në për reagim në kohë dhe të përshtatshëm në rastet e kërcënimeve, sulmeve apo ngacmimeve ndaj gazetarëve dhe gazetarëve. Në vitin 2025, fokusi i aktiviteteve të përbashkëta ishte te ngacmimi online dhe mbrojtja e gazetarëve. Në kuadër të Sektorit për Krim Kompjuterik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme u caktua një person kontakti, gjë që mundëson koordinim më të mirë dhe më të shpejtë me SHGM-në në trajtimin e këtyre rasteve.



Proces



TREGUESI 3.1

— NJËSITË E SPECIALIZUARA HETIMORE DHE/ OSE ZYRTARËT KANË EKSPERTIZËN E DUHUR PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE

Rezultati për vitin 2024: 3.42 / Rezultati për vitin 2025: 3.42

Gjendja nuk ka ndryshuar sa i përket kësaj çështjeje. Zyrtarët kompetentë për këto çështje në Ministrinë e Punëve të Brendshme formalisht disponojnë një nivel të caktuar njohurish dhe ekspertize për hetimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Gjatë vitit 2025 u aktivizuan më tej protokollet policore për reagim urgjent dhe u forcua koordinimi me pikat ekzistuese të kontaktit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në prokurori.

Megjithatë, e gjithë kjo ende nuk rezulton me përpunim mjaftueshëm efikas të rasteve, veçanërisht të kërcënimeve online dhe dhunës digjitale.

TREGUESI 3.2

— HETIMET PËR SULME SERIOZE FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIKË KRYHEN NË MËNYRË EFIKASE (TË PAVARURA, TË THELLUARA DHE NË KOHË)

**Rezultati për vitin 2024: 3.48 /
Rezultati për vitin 2025: 3.52**

Sa i përket efikasitetit në zbulimin e autorëve të sulmeve ndaj gazetarëve, gjendja duket se është përmirësuar disi krahasuar me vitet e kaluara. Në vitin 2025, SHGM në regjistrin e saj evidentoi 3 sulme serioze fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Të gjitha rastet u raportuan në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa një pjesë edhe në Prokurorinë Themelore Publike. Për të gjitha rastet procedurat përfunduan shpejt me vendime gjyqësore. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) vlerëson se mosndëshkueshmëria mbetet ende problem, për shkak se ekziston një numër i konsiderueshëm rastesh të pazgjidhura nga vitet e kaluara.

TREGUESI 3.3

— GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË MEDIATIKË MBROHEN NË MËNYRË EFIKASE NGA FORMA TË NDRYSHME TË NGACMIMEVE NË INTERNET

Rezultati për vitin 2024: 3.37 / Rezultati për vitin 2025: 3.37

Pavarësisht ndryshimeve ligjore të vitit 2023 që forcuan mbrojtjen penale, sulmet online vazhdojnë të paraqesin kërcënim për gazetarët. Në vitin 2025, SHGM regjistroi një incident serioz të ngacmimit dhe gjuhës së urrejtjes ndaj gazetarëve në rrjetet sociale, si dhe një seri fushatash të koordinuara negative të drejtuara ndaj gazetarëve nga mediat hulumtuese. Në vitet e kaluara institucionet kanë ndërmarrë veprime për disa nga sulmet më serioze, por vlerësimi i përgjithshëm është se reagimi mbetet i

ngadalshëm dhe i pamjaftueshëm i koordinuar, gjë që bën që gazetarët të mos ndihen mjaftueshëm të sigurt.

TREGUESI 3.4

— HETIMET PËR TË GJITHA LLOJET E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIKË KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Rezultati për vitin 2024: 3.10 / Rezultati për vitin 2025: 3.10

Pavarësisht bashkëpunimit të vendosur të SHGM-së me institucionet kompetente, gjendja në vitin 2025 mbetet e pandryshuar dhe tregon për nevojë të vazhdueshme për më shumë transparencë dhe reagim më efikas institucional. Informimi i pamjaftueshëm dhe i parregullt për rrjedhën e procedurave krijon perceptim të mosndëshkimit dhe e ul besimin e komunitetit gazetaresk në sistemin e mbrojtjes. Gjykatat themelore civile dhe penale në Shkup nuk ofrojnë informacione të detajuara për lëndët që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve, madje as kur gazetarët paraqesin kërkesa individuale me shkrim.

TREGUESI 3.5



— SISTEMET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE STATISTIKORE CILËSORE JANË VENDOSUR NGA ORGANET SHTETËRORE PËR TË PARANDALUAR MOSNDËSHKIMIN

Rezultati për vitin 2024: 3.33 / Rezultati për vitin 2025: 3.47

Gjatë vitit 2025 është vërejtur një përparim i kufizuar, por i rëndësishëm në ndjekjen statistikore të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Ministria e Punëve të Brendshme në faqen e saj zyrtare publikoi një link të veçantë për ndjekjen e këtyre incidenteve, i cili çon drejtpërdrejt në faqen zyrtare të SHGM-së dhe në Regjistrin publik të sulmeve që e mban SHGM. Megjithatë, në gjyqësor gjendja mbetet e pandryshuar. Institucionet gjyqësore ende nuk disponojnë sisteme funksionale statistikore që mundësojnë evidentimin dhe kërkimin e lëndëve sipas profesionit të palëve.

IV

Siguria reale



TREGUESI 4.1

— KËRCËNIME DHE NGACMIME QË NUK LIDHEN ME SIGURINË FIZIKE

Rezultati për vitin 2024: 3.55 / Rezultati për vitin 2025: 3.55

Gjatë vitit 2025, SHGM regjistroi dy raste të kërcënimeve, fyerjeve dhe diskualifikimeve ndaj grupeve të gazetarëve dhe mediave: rasti i parë lidhet me sulmet që përmes Facebook-ut i drejtoi ish-redaktori i një televizioni kombëtar, Dragan Pavloviq Latas, ndaj gazetarëve nga disa media, duke keqpërdorur fotografi private nga profilet e tyre; rasti i dytë lidhet me një seri publikimesh të Zoran Bozhinovskit, përmes të cilave në bazë gjinore sulmohet një grup gazetare dhe cenohet privatësia dhe reputacioni i tyre. Në vitin 2024 u regjistrua vetëm një incident nga kjo kategori.

TREGUESI 4.2

— KËRCËNIME NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

**Rezultati për vitin 2024: 3.53 /
Rezultati për vitin 2025: 3.89**

Në vitin 2025 nuk është evidentuar asnjë rast që bën pjesë në këtë kategori, ndryshe nga viti 2024 kur ka pasur një rast të tillë.

TREGUESI 4.3

— SULME REALE

Rezultati për vitin 2024: 4.22 / Rezultati për vitin 2025: 4.22

Në vitin 2025 u evidentuan tre raste të këtij lloji. Për këto raste, organet kompetente vepruan relativisht në mënyrë efikase dhe i përfunduan shpejt me vendime gjyqësore dënuese ndaj autorëve.

TREGUESI 4.4

— KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

**Rezultati për vitin 2024: 4.53 /
Rezultati për vitin 2025: 4.53**

SHGM, në vitin 2025 nuk regjistroi sulme të këtij lloji. Krahasuar me vitet e kaluara në këtë dimension, për këtë tregues, situata mbetet e pandryshuar.

Titulli origjinal
Maqedonia e Veriut – Treguesit për
shkallën e lirisë së mediave dhe Indeksi
i Sigurisë së Gazetarëve 2025

Botues
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)
Shkup, 2026



Autorët
Milan Spirovski
Verçe Todorovska Kostovska

Recenzentët e raportit
Marina Tuneva
Ivan Breshkovski

Përkthimi
Ferikan Iljazi

Fotografia e ballinës
Andrija Vukelić

Dizajni
comma.rs



Ky publikim është prodhuar me mbështetjen
financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja
e tij është përgjegjësi e vetme e autorit
dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Bashkimit Evropian.